

Annual Report 2009




Raiffeisen
BANK
Albania

Raiffeisen Bank

Raport Vjetor 2009

Përmbajtja

<i>Deklaratë nga Bordi Menaxhues i</i>	
<i>Raiffeisen International Bank-Holding AG</i>	7
<i>Mesazh i Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës</i>	9
<i>Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm</i>	11
<i>Vizioni dhe Misioni</i>	13
<i>Perspektivat dhe Planet për 2010</i>	15
<i>Raport i Bordit Drejtues</i>	17
Zhvillimet Ekonomike	17
Rezultatet Financiare	18
<i>Raporti i Segmentëve</i>	23
Segmenti i Korporatave	23
Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme	25
Retail Banking	27
Divizioni i Produkteve	27
Departamenti i Zhvillimit të Rrjetit	30
Zhvillimi i Segmenteve	31
Kanalet e Shpërndarjes	33
<i>Thesari dhe Bankingu i Investimeve</i>	35
Të Ardhura Fikse	35
Këmbimi Valutor	35
Tregu i Parasë	35
Njësia e Shitjes	36
<i>Raport i Audituesve të Pavarur</i>	39
Pasqyra e Konsoliduar e pozicionit financiar	41
Pasqyra e Konsoliduar përmbledhëse e të ardhurave	42
Pasqyra e Konsoliduar e ndryshimeve në kapital	43
Pasqyra e Konsoliduar rrjedhjes së parasë	44
Shënime për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara	45
<i>Raiffeisen Leasing</i>	91
<i>Raiffeisen Pensions</i>	92
<i>Përmbledheje për Grupin RZB dhe Raiffeisen International</i>	95
<i>Rrjeti i Degëve të Raiffeisen Bank SHA</i>	97
<i>Adresa dhe Kontakte</i>	99
<i>Raiffeisen Shpjegues Termash</i>	103



Quhej Xhovani Françesko Albani dhe ka qenë Papë nga 1700 deri në vdekjen e tij, në 1721. Ishte drejtues i Rietit dhe Urbinos, më pas u emërua Kardinal – Dhjak i Shën Mërisë në Akuiro nga Papa Aleksandri VIII, të cilin e pasoi si Papë më 23 Nëntor 1700. Papa Klementi shmangu nepotizmin. Ai ngriti një komision, të përbërë nga artistë, të cilët do të bënin statujat e apostujve për të plotësuar zbukurimin e Shën Xhovanit në Laterano. Ai gjithashtu krijoi një akademi pikturë dhe skulpturë në Kampidolio, pasuroi librarinë e Vatikanit me kodikset Orientale, si dhe drejtoi gërmimet e para arkeologjike në katakombet romake. Në vendin e tij, Urbino, ai restauroi ndërtesa të ndryshme dhe themeloi një librari publike. Papa Klementi XI lindi në një familje fisnike nga veriu i Shqipërisë, e sistemuar në Urbino në shekullin e 15-të, të cilët kishin qenë ushtarë të Skënderbeut kundër Perandorisë Osmane.

Deklaratë e Bordit Drejtues të Raiffeisen International Bank-Holding AG



I nderuar Zotëri ose Zonjë,

Ndërkohë që viti 2008 ishte "i jashtëzakonshëm" për Grupin Raiffeisen International në tërësi, viti 2009 do të kujtohet si një vit "ekstrem" dhe "sfidues". Kriza ekonomike globale dhe efektet e saj në ekonomitë e tregut relativisht të reja të Europës Qendrore dhe Lindore e vendosën grupin tonë bankar para sfidave krejtësisht të reja. Ne arritëm t'i përballonim mirë këto sfida falë modelit tonë të biznesit, i cili u përshtatet nevojave reale të bizneseve dhe individëve në 17 vende në rajon dhe i cili ka dhënë prova se është i shëndetshëm edhe në këto kohë të vështira. Është e qartë se rezultatet rekord që arritëm në vitin 2008 nuk mund të vazhdonin të ishin të tilla në një mjedis që ishte padyshim më i pafavorshmi në dekada të tëra dhe i cili bëri që shumë banka të shënonin humbje apo të shiteshin. Ndërkohë që fitimi ynë i konsoliduar (pas taksës dhe interesave të aksionerëve të vegjël) ra ndjeshëm në 212 milionë Euro, ky rezultat përsëri theksoi fuqinë e modelit tonë të biznesit dhe i tejkaloi pritshmëritë e tregut në mënyrë të qartë.

Ne përfituam nga viti i krizës 2009 për të përshtatur parametrat e strategjisë sonë me kushtet e vështira dhe për ta bërë organizatën edhe më të shëndetshme për kohët dhe detyrat që shtrihen përpara. Ndërkohë që në periudhat e mëparshme në plan të parë kanë qenë rritja dhe fitimet, në vitin 2009 ne u fokusuam në forcimin e kapitalit, menaxhimin e likuiditetit dhe riskut, si edhe uljen e kostove. Siç pritej, viti 2009 u karakterizua edhe nga një rritje e ndjeshme e kredive me probleme dhe si rezultat edhe i provigjioneve. Megjithatë rritja e kredive me probleme u ngadalësua në gjysmën e dytë të vitit, dhe kushtet e përgjithshme ekonomike u përmirësuan. Shumë vëzhgues të tregut ndajnë të njëjtën pikëpamje me ne se kjo prirje do të vazhdojë në vitin 2010. Mund të kemi kaluar pikën më të vështirë të krizës ekonomike, por viti aktual do të jetë një vit tjetër i sfidave të mëdha. Për këtë arsye mendojmë se është e rëndësishme të vazhdojmë të fokusohemi plotësisht në axhendën e përcaktuar në vitin 2009.

Jemi plotësisht të bindur se Rajoni i Europës Qendrore dhe Lindore do të jetë përsëri forca nxitëse e Europës pas krizës. Vitin e kaluar i gjithë rajoni pati një frenim ekonomik. Në disa vende të Europës Qendrore dhe Lindore ky frenim ishte më i rëndë se në Europën Perëndimore; në vende të tjera më pak. Por procesi i konvergencës që nisi para më shumë se dy dekadash do ende shumë kohë të përfundojë. Nevoja e vazhdueshme për të ecur përpara dhe për të arritur vendet e tjera pas pesë dekadash komunizmi, sipas të gjitha parashikimeve, do të bëjë që në vitet në vazhdim rajoni të ketë një rritje më të madhe se Europa Perëndimore. Përveç kësaj, është edhe shkalla relativisht e ulët e depërtimit në treg përse u përket produkteve bankare. Të gjitha këto duhet të jenë një bazë e fortë e një zhvillimi edhe më të madh e të suksesshëm për bankat që operojnë në rajon. Meqë është fjala te sukesi: besimi i klientëve tanë ka qenë dhe mbetet treguesi më i rëndësishëm në këtë aspekt. Rritja e numrit të klientëve gjatë këtij viti nga 14.7 milionë në 15.1 milionë vërteton se ne e gëzojmë këtë besim, pavarësisht nga, apo edhe për shkak të, kohëve jashtëzakonisht të këqija.

Dr. Herbert Stepic
Kryetar i Këshillit Drejtues
të Raiffeisen International Bank-Holding AG

Lidhur me Raiffeisen Bank Shqipëri, ne jemi të kënaqur të vëmë re...



Konsiderohet Babai i Egjiptit, si themelues i Egjiptit modern për shkak të reformave drastike në sferën ushtarake ekonomike dhe kulturore që ai ndërmorri. Ndërtoi kanalin ndërmjet Aleksandrisë dhe Nilit. Kushtetuta e re e Egjiptit ishte krijim i tij, sikurse ushtria dhe flota ushtarake, sistemi i taksave, rregullimi i importeve dhe eksporteve, legjislatura shëndetësore, shkollat, kolegjet dhe shtëpitë botuese.

Ai lindi nga prindër Shqiptarë në Kavala, një port i vogël në Maqedoni.

Mesazh i Kryetarit të Këshillit Drejtues



Viti 2009 ishte një vit mjaft i vështirë për bankat dhe ekonomitë në mbarë botën. Raiffeisen International zotëron banka në 15 vende në Europën Qendrore, Jugore dhe Lindore, dhe falë këtij rrjeti Raiffeisen International e ka mbyllur vitin 2009 më e fortë dhe e mirëstrukturuar.

Efektet e krizës botërore u ndjenë edhe në Shqipëri, por sistemi bankar dhe ekonomia e Shqipërisë kanë pasur një rritje të qëndrueshme. Sipas parashikimeve fillestare, rritja ekonomike pritej të ishte 4.8%, por ajo rezultoi të ishte 3.1%, përsëri një rritje e mirë krahasuar me ekonomitë europiane. Norma mesatare e inflacionit prej 2.2% ishte brenda kufirit prej 2-4% të synuar nga qeveria. Monedha lokale u zhvlerësua me pothuajse 10% përkundrejt Euros. Ky ishte faktori kryesor që ndikoi në rënien e nivelit të tregtisë.

Asetet e të gjithë sistemit bankar u rritën me 4.5%, por rritja ishte më e ulët se vitin e kaluar, kur asetet u rritën me 14.3%. Deri në muajin Maj 2009 tërheqjet e depozitave ishin 480 milionë, muaj në të cilën ndaluan edhe tërheqjet, dhe deri në fund të muajit Tetor 2009 tregu u rrit me 276 milionë Euro krahasuar me muajin Dhjetor 2008. Këtë vit kreditë u rritën me 11%, por edhe kreditë me probleme u rritën në 10.1% të totalit të kredive në Tetor 2009 krahasuar me 6.6% në Dhjetor 2008.


Banka Raiffeisen mbetet banka më e madhe në vend përsa u përket depozitave, kredidhënies, rrjetit të degëve dhe bankomateve, si edhe përfitueshmërisë. Rritja vazhdoi edhe në vitin 2009. Deri në 31 Dhjetor 2009, depozitat ishin 1,505 milionë Euro; kreditë për klientët 677 milionë Euro, numri i degëve ishte 102, numri i bankomateve 215, kthimi nga kapitalet (pas taksës) 23.41%.

Banka jep një kontribut të madh në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë nëpërmjet mbështetjes së investitorëve ndërkombëtarë, prodhuesve lokalë, dhe projekteve në infrastrukturë.

Gjatë gjithë vitit stafi ka punuar shumë për të përmirësuar produktet e ofruara dhe për të siguruar standarde të larta të shërbimit ndaj klientit.

Si Kryetar i Këshillit Drejtues përfitoj nga rasti për të falënderuar menaxherët tanë dhe stafin për përpjekjet e tyre dhe klientët tanë për mbështetjen që na kanë dhënë.

Heinz Hödl
Kryetar i Bordit Mbikqyrës



Karl Gega ishte projektuesi i Hekurudhës Semering nga Glognic në Myrcushlag. Ai ndihmoi në ndërtimin e rrugës nga Kortina d’Ampeco në Toblah – Dobiako. Ai nisi me planifikimin e linjës hekurudhore në jug, nga Myrcushlag në Grac dhe Trieste. Kalimi i Semeringut dukej i pamundur, por ai ngriti një plan për ta kaluar Semeringun me lokomotiva pa një binar ekstra për ingranazhet.

Ka lindur në Venecia në një familje Shqiptare, studioi në Padova, ku dha provimin për doktoraturë në matematikë që në moshën 18 vjeçare.

Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm



Siç e parashikova në mesazhin tim në Raportin Vjetor 2008, viti 2009 ishte një vit i vështirë për Shqipërinë. Me një rënie të ekonomisë, Raiffeisen Bank SHA pati një ngadalësim të rritjes. Bilanci ynë u ul me 214 milionë Euro (10.5%) në 1.825 miliardë Euro. Megjithatë ne ruajtëm pozicionin numër një në tregun bankar në të gjithë matësit kryesore.

Besimi te bankat u kthye në fund të vitit dhe depozitat e Bankës Raiffeisen filluan të rriteshin përsëri. Ne hodhëm në treg depozitën e "Kursimeve për fëmijë" dhe depozitën "Hap pas Hapi", duke përmirësuar gjithashtu edhe kushtet e depozitës sonë të njohur me afat.

Gjatë vitit 2009 kompanitë dhe individët u mbështetën më pak te kredidhënia bankare ndërkohë që rënia ekonomike ndikoi në biznesin dhe të ardhurat e tyre. Si rezultat kredidhënia jonë ra me 1.3% në 677 milionë Euro, ndërkohë që ne vazhduam të jepnim kredi për kompanitë më të mëdha, si ato ndërkombëtare, ashtu edhe ato vendase.

Niveli ynë i likuiditetit i cili matet nga raporti kredi / depozita ishte mjaft i lartë në 45%, që do të thotë se ne nuk e ndaluam asnjëherë kredidhënien dhe ishim në gjendje të investonim fonde në Bono Thesari dhe Obligacione të Qeverisë Shqiptare, duke e ndihmuar kështu edhe më shumë ekonominë.

Ne vazhduam fokusin tonë në përmirësimin e rrjetit tonë të gjerë të degëve dhe shtuam edhe dy degë dhe zhvendosëm tri të tjera. Shërbimi ndaj klientit vazhdoi të ishte në fokusin tonë, dhe nga komentet që kemi marrë nga skema e sugjerimeve të klientëve dhe gojarisht nga klientët, duket se përpjekjet tona po njihen dhe po vlerësohen.


Me uljen e kërkesës për produktet tona të kredive ne përfituam nga rasti për të rishikuar shumë procese dhe procedura dhe për të centralizuar dhe automatizuar ku të ishte e mundur. Fitimet në efikasitet që rezultuan nga këto të fundit, si edhe një shqyrtim i kujdesshëm i shpenzimeve të përgjithshme çuan në uljen e kostove dhe në një raport të ulët kosto / të ardhura prej 32.1%.

Raiffeisen Leasing vazhdoi të mbetej një zgjedhje mjaft e pëlqyer për kompani dhe individë që donin të financonin makineri, pajisje, automjete për transport mallrash dhe makina. Raiffeisen Leasing zë vendin e parë në tregun e leasing-ut në Shqipëri.

Raiffeisen Pensions u ble në fund të vitit 2008. Në vitin 2009 kompania ruajti vendin e parë në tregun e pensioneve, ndërkohë që është riorganizuar dhe përgatitur për Ligjin e ri të Pensioneve, i cili u miratua në Parlament në Dhjetor. Në vitin 2010 do të hidhet në treg një linjë e re e produkteve të pensioneve sapo të ketë përfunduar instalimi i sistemit të ri kompjuterik.

Viti 2010 nuk do të jetë një vit me një rritje të ndjeshme ekonomike, dhe Bankës do t'i duhet të përpiqet shumë për të arritur pikësyzimet e saj. Megjithatë stafi ynë është entuziast, i përkushtuar dhe i vendosur që Raiffeisen të vazhdojë të qëndrojë në krye të sistemit bankar në Shqipëri. Dëshiroj t'i përgëzoj zyrtarisht të gjithë për kontributin e tyre në zhvillimin e Bankës në vitin 2009.

Oliver J. Whittle
Drejtor i Përgjithshëm
Anëtar i Bordit Drejtues



Lindur me emrin Elena Gjika, ishte një shkrimtare romantike Rumuno -Shqiptare dhe feministe.

Si shkrimtare, nën emrin Dora d'Istria, ajo publikoi një sërë veprash mbi pikëpamjet e saj liberale për çështjet politike dhe fetare. Pozicioni i saj në përgjithësi ishte kozmopolit, por ajo e ndjente si detyrë të përhapte burimet e civilizimit Perëndimor në Lindje dhe të punonte për emancipimin e gjinisë së saj. Dora d'Istria ishte gjithashtu edhe piktore.

Ajo ishte gruaja e parë që ngjiti Malin e Bardhë, më 1 Qershor 1860.

Vizioni

Vizioni ynë është të ndërtojmë një standart bankar, duke ndryshuar jetën e klientëve tanë nëpërmjet ofrimit të produkteve më të mira dhe një shërbim ndaj klientit të një cilësie të lartë.

Misioni

Ne kërkojmë marrëdhënie afatgjata me klientët.

Si anëtare e Grupit RZB, ne ruajmë një bashkëpunim të ngushtë me Raiffeisen Zentralbank dhe me bankat e tjera të Grupit Bankar Raiffeisen.

Ne arrijmë një kthim mbi kapitalin të qëndrueshëm dhe mbi mesataren.

Ne i japim mundësi punonjësve tanë të jenë sipërmarrës, të tregojnë iniciativë dhe nxisim zhvillimin e tyre.

Bordi Drejtues i Raiffeisen Bank SHA



Anëtarët e Bordit Drejtues të Raiffeisen Bank SHA (nga e Majta në të djathtë):
Christian Canacaris, Peter Hakkenberg, Robert Wright.

Perspektivat dhe Planet e ardhshme për vitin 2010

Pas një viti sfidues në 2009, Banka Raiffeisen vazhdon të punojë për të ardhmen nga një pozicion mjaft i fortë. Konkurrenca do të mbetet e lartë në vitin 2010 pavarësisht nga presionet e vazhdueshme globale në ekonominë lokale. Viti 2010 është një kohë për t'u afruar edhe më shumë me klientët dhe për të punuar me ta për të arritur së bashku suksesin në një mjedis të vështirë duke vazhduar investimet në produkte, shërbime dhe teknologji të reja.

Një ekuilibër mes risive për të ardhmen, vazhdimin të përsosurisë në efikasitetin e kostove dhe përmirësimit të cilësisë së biznesit ekzistues do të jetë perspektiva jonë për vitin e ardhshëm.

Cilësia e shitjes dhe shërbimit do të vazhdojnë të jenë gur themeli i përpjekjeve të bankës, që do të realizohet nëpërmjet trainimit të vazhdueshëm të punonjësve, kushteve më të favorshme të produkteve, zhvillimit të segmentimit me oferta shërbimesh për kategori të veçanta klientësh dhe mjeteve të reja të shërbimit.

Bankingu i Korporatave do të vazhdojë të përmirësojë aftësitë dhe njohuritë e punonjësve me qëllim që të ruajë avantazhin e saj konkurrues si banka numër një në treg dhe si një bankë me fokusin te klienti. Do të hidhen në treg produkte të reja të kredive për korporatat, të menaxhimit të cash-it dhe të financimit të projekteve, të ndërthurura me oferta të bëra posaçërisht, me qëllim plotësimin e nevojave të veçanta të klientëve të mëdhenj. Gjatë vitit do të zhvillohen edhe risi të tjera teknologjike.

Në fillim të vitit do të përfundojë prezantimi në treg i Premium Banking-ut, ndërkohë që zgjerimi i bazës së klientëve Micro dhe depërtimi i produkteve në treg do të vazhdojë me procese më të shpejta dhe me një prani më të madhe në degë për t'u shërbyer këtyre klientëve.

Në të gjitha segmentet rritja e cilësisë së portofolit të kredive do të realizohet me një menaxhim me efektiv të cilësisë së portofolit në çdo linjë biznesi, me theksin të kredidhënira në monedhën lokale për individët dhe bizneset e vogla, dhe me anë të ndërthurjes së kredidhënies me paketa bankare për një shërbim të plotë në të gjitha segmentet.


Banka do të vazhdojë t'u ofrojë klientëve mundësi të shkëlqyera për depozita dhe kursime nëpërmjet kushteve të reja të produkteve dhe normave tërheqëse.

Shërbimi bankar elektronik për individët do të plotësohet nëpërmjet prezantimit të Pagesave me Celular, që do të krijojë fleksibilitet mjaft të lartë për klientët individë dhe mundësi për të kryer transaksionet e tyre bankare nëpërmjet telefonave celulare nga çdo vend dhe në çdo kohë. Rrjeti i degëve vazhdon të përmirësohet me standarde të reja që po prezantohen dhe disa degë do të zhvendosen në vende më të përshtatshme dhe më të mëdha për t'u shërbyer më mirë klientëve tanë.

Në përgjithësi, klientët mund të presin të vazhdojnë të marrin shërbime dhe kushte më të mira me një akses më të lehtë bankar ndërkohë që Raiffeisen vazhdon të jetë e përkushtuar për të rritur standardet bankare dhe për të ndihmuar në përmirësimin e klientëve tanë.



Oliver Whittle
Drejtor i Përgjithshëm
Kryetar i Bordit



Robert Wright
Anëtar Bordi
për Biznesin Retail



Christian Canacaris
Anëtar Bordi për Korporatat, Thesarin
e Bankingun e Investimeve



Peter Hakkenberg
Anëtar Bordi për
Operacionet dhe TI-në



Sami Frashëri ishte një shkrimtar, filozof, dramaturg dhe figurë e spikatur e Lëvizjes Kombëtare të Rilindjes.

Ai ka dhënë një nga kontributet më të mëdha për reformat në gjuhën Turke. Ndërkohë, mesazhi i Frashërit, siç është deklaruar në librin e tij "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet", u bë manifesti i Rilindjes Kombëtare.

Frashëri ka diskutuar perspektivën për një Republikë të lirë dhe të pavaruar të Shqipërisë, duke nisur kështu me kërkesën për autonomi dhe ka luftuar për alfabetin e tyre si dhe edukimin. Ai lindi në Frashër, Kolonjë.

Raporti i Bordit të Menaxhimit

Zhvillimet Ekonomike

Gjatë vitit 2009 ekonomitë e vendeve të Europës Juglindore u testuan fort nën efektet e krizës që goditi puthajse të gjithë Europën. Megjithatë, ekonomia Shqiptare ishte e vetmja nga të gjitha vendet e rajonit që shënoi një rritje positive të PPB. Sipas Ministrisë së Financave kjo rritje deri në muajin Nëntor 2009 ishte 3.1%.

Sektorët e industrive që kontribuan kryesisht në këtë rritje të PPB ishin, telekomunikacionet që përbëjnë rreth 34.3% të PPB, transporti 15.5% dhe tregëtia me 6.4%. Përkundrazi sektori i ndërtimit pësoi një rënie të ndjeshme krahasuar me vitet e shkuara, duke evidentuar ndjeshmërinë e këtij sektori ndaj kushteve aktuale ekonomike.

Pasojat e krizës, që u ndjenë më shumë në ekonominë Shqiptare, ishin në lidhje me kursin e këmbimit të Lekut kundrejt Euros dhe monedhave të tjera kryesore. Zhvlerësimi vjetor i Lekut ndaj Euros arriti maksimumin e tij historik duke bërë që monedha Shqiptare të zhvlerësohet me 10.2% kundrejt Euros.


Pavarësisht këtyre efekteve, stabiliteti i faktorëve makroekonomik si edhe mungesa e presioneve nga kërkesa e brendshme, absorbuan dhe balancuan presionin e shkaktuar nga zhvlerësimi i monedhës vendase. Niveli i inflacionit qëndroi brenda limiteve të përcaktuara 2-4%, dhe vlera mesatare vjetore e tij shënoi nivelin 2.2% për vitin 2009.

Gjatë vitit 2009, shpenzimet qeveritare u rritën me 3.4% krahasuar me një vit më parë ndërsa të ardhurat u rritën vetëm 16.4%.

Për sistemin bankar në Shqipëri viti 2009 vazhdoi të ishte një vit pozitiv, ndonëse me një rritje më të ulët sesa vitet e fundit. Totali i aktivitetit të sistemit bankar u rrit me 6.3% ndërsa niveli i kreditimit u rrit me 13.4% ose me 365 milion Euro krahasuar me një vit më parë. Tërheqja masive e depozitave bankare gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit arriti në vlerën e 480 milion Euro. Gjatë gjysmës së dytë të vitit situata u përmirësua rrënjësisht duke rikuperuar të gjitha tërheqjet që ndodhën në gjysmën e parë të vitit dhe në fund të vitit volume i depozitave në sistemin bankar ishte rritur me 356 milion Euro krahasuar me një vit më parë.

Në fund të vitit 2009, dërgesat e emigrantëve në Shqipëri rregjistruan në vlerën e 580 milion Euro ose 6.7% me pak sesa në vitin 2008.


Rritja e Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (% nga viti në vit)



Rezultate Financiare


Raiffeisen Bank SHA ka mbyllur vitin 2009 me një volum total asetesh prej 253,203 milion LEK krahasuar me 253,589 milion LEK në vitin 2008. Struktura e asetëve përbëhet nga investime të sigurta, të cilat përbëjnë 51% të asetëve të bankës për vitin 2009 krahasuar me 54% të tyre në vitin 2008. Portofoli i kredive në bankë është rritur gjatë vitit 2009 duke arritur 35% të totalit të asetëve, krahasuar me 33% në vitin 2008.

Struktura e Bilancit - Aktivi (në '000 LEK)




Totali i huave dhe paradhënieve për klientët në fund të vitit 2009 ishte 94,277 milion LEK krahasuar me 85,646 milion LEK në vitin 2008 duke përfaqësuar kështu një rritje prej 10% të portofolit të kredisë gjatë këtij viti. Portofoli i kredisë është kryesisht i përbërë nga kreditë e korporatave me 59% të totalit të portofolit të kredisë dhe zuri vendin kryesor në këtë portofol me një tepicë kredie prej 55,171 milion LEK krahasuar me 43,719 milion LEK në vitin 2008. Segmentet e Ndërmarrjeve të Mesme dhe Individëve shënuan një rënie në portofolin e kredisë përkatësisht 16% dhe 8%. U shënuan një rritje në portofolin e kredisë për ndërmarrjet e vogla prej 547%, ose në vlerë absolute, me një tepicë prej 1,952 milion LEK, krahasuar me një total prej 302 milion LEK në vitin 2008.

Struktura e Hua dhe Paradhënie për klientët (në '000 LEK)




Struktura e afateve të portofolit të kredive bankare gjatë vitit 2009, përbëhet kryesisht nga një kombinim i kredisë afatmesme dhe paradhënie bankare përkatësisht prej 19% dhe 48% të totalit të portofolit të kredisë. Kreditë afatmesme kanë pësuar një rënie nga 22% për vitin 2008 në 19% për vitin 2009. Paradhëniet bankare vazhdojnë të jenë komponenti kryesor i portofolit të kredisë, duke mbajtur të njëjtën përqindje si në vitin 2008. Kredia afatgjatë përfaqëson 20% të totalit të portofolit të Bankës për 2009 krahasuar me 19% për 2008, duke treguar një rritje të vogël.

Kredi gjatë vitit 2009 (in '000 LEK)




Totali i detyrimeve në fund të vitit 2009 ishte 253,203 milion LEK (2008: 253,589 milion LEK). Pjesën më të madhe të detyrimeve e zënë depozitat e klientëve, të cilat përbëjnë rreth 82% të totalit të detyrimeve, ka një ulje të vogël krahasuar me 85% të totalit të detyrimeve të bankës për vitin 2008.

Struktura e Bilancit - Pasivi (në '000 LEK)




Struktura e afateve të depozitave tregon një trend drejt depozitave me afat të gjatë. Gjatë vitit 2009, profili i depozitave të klientëve ka vazhduar më me trend si vitin e kaluar duke vendosur depositat e tyre me afate të gjata maturimi me qëllim përfitimin nga interesat më të larta. Totali i depozitave të klientëve në fund të vitit 2009 është 163,231 milion LEK (2008: 172,965 milion LEK).

Deposits Structure (in '000 LEK)




Fitimi neto për vitin 2009 pas taksës shënoi një rënie 8% në krahasim me 2008, në vlerë absolute është 4,694 milion LEK krahasuar me 5,095 milion LEK për vitin 2008. Kjo ka patur një imakt direkt duke ndryshuar raportin e kthimit mbi kapitalin në rritje, nga 34% në 2008 në 23% në 2009 Dividendi i deklaruar dhe i paguar në 2009 është 0 LEK (2008: 699,722 mijë LEK).

Struktura e Kapitalit Aksioner (në '000 LEK)



E ardhura neto nga interesat u rrit me 7% ose nga 10,042 milion LEK në 2008, në 10,776 milion LEK në 2009. Bilanci i bankës tregon një rënie prej 0.2%, kombinimi i të cilës me rritja e të ardhurës nga interesat, ndikoi në përmirësimin e kësaj të ardhure (llogaritur si raport i të ardhurës nga interesat mbi mesataren vjetore të totalit të aktiveve) duke e rritur atë me 16 pikë ose shprehur ndryshe nga 4.09% në 2008 në 4.25% në 2009.


Net Income (in '000 LEK)



Shpenzimet administrative në total gjatë 2009 arritën në 1,487 milion LEK krahasuar me 1,877 milion LEK në 2008. Kjo rënia ka përmirësuar eficientën operuese të Bankës – raportin kosto/të ardhura nga 40.06% në 32%. Në kategorinë e shpenzimeve “Tarifa dhe Konsulencë Ligjore” përfshihen dhe shpenzimet për administrimin e zyrës qendrore, të cilat arrijnë në 211 milion lekë (2008: 626 milion lekë).

Shpenzimet për stafin u ulën me 10% ose 1,743 milion LEK në 2009 krahasuar me 1,947 milion LEK në 2008.

Shpenzime operative 2008 (në '000 LEK)





Faik Konica është një nga figurat më të shquara të Shqipërisë Pasqyra e tij letrare, Albania, u bë publikimi kryesor i shkrimtarëve Shqipëtarë që jetonin jashtë. Faik Konica shkroi pak si letrar, por si stilizues, kritik, publicist dhe figurë politike ai pati një ndikim të jashtëzakonshëm në kulturën dhe stilin e të shkruarit Shqip. Ndihamoi në përhapjen e dijenisë, për kulturën dhe çështjen Shqiptare në të gjithë Europën dhe pati një ndikim shumë të madh në zhvillimin dhe rafinimin e prozës Shqiptare

Me fjalët e poetit francez Gijom Apoliner (Guillaume Apollinaire)

“Konica i transformonte shprehjet e trasha të haneve të marinarëve, në një gjuhë të pasur dhe të zhdërvjellët”

“Nga të gjithë njerëzit që kam njohur dhe mbaj mend me kënaqësi të madhe, Faik Bej Konica është më i pazakonti”.


Raporti i Segmenteve

Segmenti i Korporatave


Pavarësisht nga përkeqësimi i situatës globale ekonomike Segmenti i Korporatave vashdoi të rrisë portofolin, edhe pse vlen të përmendet që kjo u arrit duke u përballur me sfida të vazhdueshme.

Në vijë të përgjithshme performanca e këtij segmenti ishte brenda pritshmërisë. Një kategori klientësh mjaft cilësore vijon të qëndrojë besnikë, kjo si rezultat i manaxhimit të kujdesshëm dhe të frytshëm të marrëdhënieve me këta klientë dhe një përfaqje profesionale nga ana e stafit cilësor dhe të trajnuar të bankës. Raiffeisen Bank vazhdon të ketë pozicionin e liderit në treg edhe gjatë vitit 2009, me fokusin tek klientët egzistues, por në të njëjtën kohë duke mos lënë mënjanë edhe klientët e rinj.

Struktura e portofolit të kredisë Segmenti i Korporatave



Ndarja e portofolit të kredisë Segmenti i Korporatave



Njësia e Projekteve Financiare u organizua gjatë vitit 2009 me objektiv të mbështeste klientët me ndihmë më të specializuar. Kjo njësi e re u tregua mjaft aktive duke dhënë kontributin e saj në transaksionet e suksesshme të financimit të projekteve.

Ekspertët e Divizionit të Korporatave ofrojnë një diapason të gjerë produktesh dhe shërbimesh me shtrirje në të gjithë vendin, duke propozuar kështu zgjidhje të problemit të financimit të dizenuara në përputhje me kërkesat e klientëve.

Nga pikpamja e segmenteve, Divizioni i Korporatave është i fokusuar në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me:

- Korporatat vendase të cilat operojnë në tregun shqiptar
- Korporatat ndërkombëtare të interesuara të investojnë në tregun shqiptar
- Institucionet Publike dhe Qeveritare qendrore dhe lokale
- Institucionet Financiare

Shërbimi i shkëlqyer i klientelës së Raiffeisen Bank dhe njohja mjaft e mirë e nevojave të larmishme të klientëve ka dhënë frytet e saj në ndërtimin e marrëdhënieve të ngushta të biznesit me operatorë të industrive si: Prodhim dhe shpërndarje karburanti, gaz të lëngshëm, sektori i energjisë elektrike (financim i impianteve të prodhimit të energjisë), projekte infrastrukturore, prodhimin, tregtise, etj.

Synimi i Divizionit të Korporatave është të ndërtojë marrëdhënie afatgjata me klientë korporatë të cilët

paraqesin një shkallë ekspozimi të ulët dhe që janë lider në sektorët ku operojnë.

Të ardhurat e përgjithshme bruto të realizuara nga Divizioni i Korporatave gjatë vitit 2009 u rritën me 27.2% krahasuar me ato të një viti më parë. Kjo u arrit nëpërmjet kontrollit të kostove dhe huadhënies së analizuar me kujdes.

Portofoli i kredisë shënoi një rritje prej 13% krahasuar me një vit më parë duke çuar volumin e financimit në 386 milion Euro, një rritje neto prej 44 milion Eurosh. Edhe pse problemet ekonomike globale bënë që të rritej portofoli i kredive të këqia, problem ky i cili po trajtohet me agresivitet, rezultatet e biznesit tone dhe shancet që ofron Shqipëria na bëjnë të jemi optimist për ta zhvilluar biznesin edhe gjatë vitit 2010 e në vazhdim.


Përqindjet për produktet e portofolit të kredisë tregohen në vijim.

Struktura e klientëve Korporatë për vitin 2009 konsiston në:

- 44% Korporata Ndërkombëtare
- 31% Korporata Vendase
- 22% Institucione Publike
- 3% Institucione Financiare

Të ardhurat nga shërbime të tjera jo-huadhënëse si për shembull këmbimet valutore dhe pagesat ishin të qëndrueshme krahasuar me një vit më parë

Transaksionet e këmbimit valutor 2008 kundrejt 2009



Raiffeisen Bank ka patur privilegjin t'u shërbejë 862 klientëve më të mëdhenj në Shqipëri duke vepruar si këshilltar kryesor financiar për më shumë se 24% prej tyre. Si pjesë e grupit bankar Raiffeisen International – bankë lider në Europën Qendrore dhe Juglindore ne kemi dhënë kontributin tonë në rritjen e investimeve të huaja në projekte të mëdha, në nisma të ndryshme brenda grupit si pagesat brenda grupit, etj....

Sektori Publik

50% e shpenzimeve të buxhetit të shtetit kryhen nëpërmjet rrjetit të degëve të Raiffeisen Bank SHA. Pozicioni lider në sektorin publik vjen si rezultat i produkteve dhe shërbimeve të dedikuara dhe sistemeve të komunikimit të dizenuara në mënyrë specifike për të kënaqur kërkesat unike të këtij sektori.

Sektori i energjisë mbetet prioritet për ekipin e Institucioneve Publike, duke ndërtuar marrëdhënie afatgjata nëpërmjet angazhimeve kontraktuale, marrëveshjeve të nënshkruara dhe linjave të financimit me operator aktiv të kësaj industrie

Duke vazhduar më tej, një nga bashkëpunimet që vlen të përmendet është pikërisht ai me institucionet financiare dhe kompanitë e sigurimit duke u ofruar shërbime dhe produkte të zhvilluara sipas kërkesës së tyre.

Menaxhimi i Produkteve të Cash-it

Banka Raiffeisen është e vetmja bankë në Shqipëri, e cila ka krijuar një ekip të dedikuar për Menaxhimin e CASH-it brenda divizionit të korporatave.

Produktet e njësisë së Menaxhimit të Cash-it ofrojnë shërbime efikase të menaxhimit të likuiditetit dhe produkteve të një rëndësie të veçantë për klientët Korporatë vendas dhe të huaj. Shërbimet e Menaxhimit të Cash-it dhe pagesave përbëjnë janë pjesë thelbësore e segmentit të korporatave.

Shërbimet dhe produktet e Menaxhimit të Cash-it ofrojnë:

- Orientim drejt biznesit dhe klientit
- Risi në produkte
- Zgjidhje nëpërmjet e-business
- Transparencë të çmimeve
- Shërbime globale

Gjatë vitit 2009 rëndësi e veçantë i është kushtuar produkteve të ndryshme jo-huadhënëse. Në këtë kuadër ne kemi prezantuar produkte të reja, kemi përmirësuar shërbimin e klientëve ndaj biznesit, si dhe kemi trajnuar stafin në mënyrë që të kënaqim kërkesat e klientëve tanë.

Bashkpunimi me grupin RZB dhe me bankat e tjera të rrjetit bankar RI për Produktete e Menaxhimit të Cash-it, ka rezultuar në sukses, duke iu përgjigjur kërkesave të klientit me SHPEJTËSI, EFIKASITET, SIGURI dhe CILËSI.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme


Gjatë 2009, segmenti i biznesit të mesëm (SE) shfaqti në përgjithësi vështirësi financiare si rrjedhojë e situatës ekonomike në tregun botëror. Megjithatë, ekipi i segmentit SE veprroi me maturi dhe kujdes duke kredituar vetëm biznese me parametra shumë të mira financiare dhe duke u ofruar atyre shërbime të tjera jo – hua si: transaksione këmbimi në monedhë të huaj, produkte të instrumentave financiare, depozita dhe shërbime të tjera pagese. Përgjigjja jonë ndaj situatës së re të tregut gjatë vitit 2009 ishte të modifikonim strategjinë e segmentit SE duke e adoptuar atë më mirë ndaj kushteve korente të tregut dhe pritshmërive në afatmesëm.

Raiffeisen Bank është banka e parë në Shqipëri që dallon shërbimin ndaj Bizneseve të Vogla (Segmenti Mikro) dhe Bizneseve të përmasave të Mesme (Segmenti SE) në mënyrë që të garantojë përkujdesje të dedikuar për secilin prej këtyre grupimeve. Gjatë vitit 2009 pati një migrim masiv të llogarive të klientëve SE (depozita dhe kredi) në Segmentin e ri të promovuar të Bizneseve Mikro. Procesi u realizua me sukses dhe mundësoi ofrimin e produkteve të ndryshme të përshtatshme me përmasat e këtyre kompanive.


Gjithashtu për Segmentin SE u aplikua një strukturë e re manaxhimi gjatë 2009, Oficerët e Kredisë u integruan nën Manaxhimin Zonal duke u shpërndarë në 100% të Zonave duke qënë në gjendje të shërbejnë bizneset të mesme në gjithë territorin e Shqipërisë.

Pavarësisht kushteve të tregut dhe politikës së rishikuar të kredidhënies, ne mundëm të rrisim volumin e kredive të dhëna Kompanive të përmasave të Mesme, duke arritur në një portofol prej 99.22 milion Euro. Fokus i veçantë iu dha strukturës së portofolit dhe minimizimit të riskut nga këmbimi duke synuar një portofol optimal të strukturuar si më poshtë:

Portofoli i Ndërmarrjeve të Mesme: Overdraft (Kredi Kufi) kundrejt Kredi Personale



Portofoli i Ndërmarrjeve të Mesme: monedha vendase kundrejt monedhës së huaj



Në këtë vit synimi ynë ishin takime në mënyrë frekvente me klientët tanë, të siguronim njohje më nga afër të klientëve tanë dhe këshillimi i tyre në mënyrë aktive si të përballojnë sfida të reja për aktivitetin e tyre. Ne çmujmë se një marrëdhënie e fortë profesionale me klientët e biznesit është shumë e rëndësishme për bankën për të kuptuar më mirë situatat dinamike të klientëve veçanërisht në sfidat e tyre për të përballuar shtrëngimet financiare dhe ekonomike gjatë vitit 2009. Nga ana tjetër, ne besojmë se edhe klientët kanë nevojë të kenë partnerë të besueshëm dhe profesionale në mënyrë që të përfitojnë nga suporti i tyre në situata të vështira dhe të paparashikueshme financiare.

Retail Banking

Organizimi menaxherial i Retail Banking është bërë më efektiv në fund të 2009 - ës me përfshirjen e kredive hipotekare në Divizionin e Produkteve dhe zgjerimin e departamentit të Zhvillimit të Segmenteve. Divizioni i Produkteve menaxhon të gjithë zhvillimet e produkteve për Retail-in dhe bën suportin ditor të degëve. Përveç kësaj, menaxherët e produkteve drejtojnë strategjinë dhe rezultatet e biznesit duke iu përshtatur produkteve dhe duke u siguruar kështu që Raiffeisen Bank të jetë udhëheqës në treg me produkte konkurruese që plotësojnë kërkesat në rritje të konsumatorëve, dhe të japë fitimin e pritur.

Departamenti i Zhvillimit të segmentit drejton strategjinë e konsumatorit, segmentimin dhe aktivitete me në qendër konsumatorin nëpërmjet zhvillimit të Menaxhimit të Marrëdhënieve me Konsumatorin (CRM). Ky Departament kujdeset gjithashtu për të siguruar një pozicion kryesor në treg për segmentet Premium Banking dhe Bizneset e Vogla.

Departamenti i Zhvillimit të Rrjetit është përgjegjës për të krijuar dhe ruajtur rrjetin kryesor të kanaleve të Retailit, për të mbështetur pozicionin kryesues në treg dhe për të shfrytëzuar zhvillimet teknologjike duke ju përgjigjur kërkesave gjithmonë në rritje të konsumatorëve. Kjo përfshin përmirësimin e rrjetit tashmë të gjerë të degëve dhe ATM-ve, zgjerimin e rrjetit të POS-eve (pikave të shitjes) dhe zhvillimin e kanaleve të reja elektronike bankare.

Divizioni i Kanaleve të Shpërndarjes menaxhon shitjet dhe shërbimet në të gjithë rrjetin e degëve, si dhe rrjetin e shitjeve direkte.

Divizioni i Produkteve


Kartat e Kreditit

Edhe pse kemi ende një numër të vogël kartash në treg, kartat e kreditit patën një rritje të limitit të mbartur prej 102% gjatë vitit 2009 dhe një rritje prej më shumë se 107% të normës së përdorimit të shumës (revolving limit). Kjo është arritur duke promovuar Kartën e Kreditit Revolving (pagesë me këste), duke zëvendësuar kartën e krediti Charge (pagesë e plotë) dhe duke arritur një rritje në përdorimin e kartës për më shumë se 50%. Klientët tanë kanë vlerësuar kartën e kreditit revolving si më tërheqëse se sa karta charge për shkak të fleksibilitetit në funksion të shlyerjes mujore minimale.

Fokusi për 2010 është rritja e numrit të kartave të kreditit të dhëna klientëve ekzistues dhe nxitja e përdorimit të POS-eve (blerjet me kartë).

Kartat e Debitit

Gjatë vitit 2009 numri i kartave të debitit është rritur me 7%, duke tejkalluar 200.000 karta me më shumë se 4.5 milion transaksione të kryera nëpërmjet ATM-ve dhe POS-eve. Banka jonë ka numrin më të madh të kartave në Shqipëri.

Numri mujor i transaksioneve**Klientë me pagë të depozituar në Bankë**


Klientët që marrin pagat e tyre nëpërmjet bankës sonë mbeten grupi më i rëndësishëm i klientëve tanë, duke siguruar mundësi shitjeje, veçanërisht për produktet e kredisë.

Raiffeisen Bank është lider në këtë segment me pjesën dominuese të tregut. Si e tillë, të gjithë konkurrentët kanë si objektivë të tyre tërheqjen e klientëve tanë.

Në 2010 ne do të fokusohemi në të dy drejtimet; mbajtjen (mbrojtjen e pozicionit tonë udhëheqës në treg) dhe rritjen cilësore – që do të thotë tërheqjen e atyre konsumatorëve që kanë një pagë më të lartë se mesatarja të procesuar në sistemin bankar.

Avantazhet kryesore konkurruese për Raiffeisen në këtë segment është ekspertiza jonë për një procesim të shpejtë të pagave; rrjeti ynë i ATM-ve (dy herë më i madh se konkurenti më i afërt) dhe rrjeti i degëve tona (gati dy herë më shumë se çdo bankë tjetër). Megjithatë, konkurruesit pritet të ulin komisionet e paketave të llogarisë duke tentuar të fitojnë klientë. Në përgjigje, ne do t'i shtojmë vlera propozimit tonë dhe do të ofrojmë disa opsione paketash në 2010 për të ruajtur bazën tonë të konsumatorëve pa qenë e nevojshme të heqim dorë prej të ardhurave nga komisionet.


Përbërja e klientëve të rinj



Llogaritë Rrjedhëse

Numri i llogarive rrjedhëse për segmentin e individëve u rrit me 12% gjatë vitit 2009. Klientët e rinj individë janë një kombinim i atyre që marrin pagën nëpërmjet bankës dhe atyre me llogari rrjedhëse të thjeshtë. Depozitat e Kursimeve për fëmijë gjithashtu pësuan rritje, si pasojë e komunikimeve dhe produkteve të targetuara.

Transfertat e Parave



Transfertat e Parave

Transaksionet vazhdojnë të kenë epërsi në pagesat hyrëse, Shqipëria është kryesisht një treg përfitues për shkak të dërgesave të larta nga familjarët emigrantë që punojnë jashtë. Gjatë vitit 2009, fokusi i menaxhimit të produkteve ishte në riorganizimin e proceseve të pagesave në mënyrë që të përmirësohej shërbimi ndaj konsumatorit dhe të arrihej efica e kostove nëpërmjet reduktimit të kohës së transaksioneve.

Depozitat

2009 ishte një vit i vështirë për të gjitha bankat në Shqipëri për shkak të efekteve të krizës globale. Objektivimi për depozitat për individë ishte stabilizimi dhe mbajtja e bazës së depozitave tona, të cilën ne e realizuam nëpërmjet fushatave të marketingut dhe produkteve të reja.

Produktet e reja përfshinë një depozitë të përshkallëzuar (Hap pas Hapi) dhe opsionin e pagesës mujore të intereseit.

Me bazën e depozitave tashmë të qëndrueshme, sfida jonë e në vazhdim është balancimi i pjesës së tregut me likuiditetet optimale për bankën, si dhe mbajtja e një marzhi të arsyeshëm kundërt disa taktikave të çmimeve në disa raste agresive të ndermarra nga disa konkurrentë

Kreditë

Aktiviteti kreditues u ngadalësua në mënyrë të konsiderueshme në treg për shkak të rënies ekonomike. Fokusi në 2009-ën ishte menaxhimi i cilësisë së portofolit dhe përmirësimi i proceseve dhe produkteve, në pritje të një kthimi gradual në nivele normale të huadhënies për 2010-ën. Përmirësimi i procesit të mbledhjes së kredive me vonesë, rishikimi i politikave të kreditimit, procese të reja pune dhe projektimi i një sistemi të ri aplikimin, ishin pjesë e fokusit të 2009-ës, në mënyrë që të krijohet një bazë e fortë nga ku të rinisë një rritje e shëndetshme e portofolit për 2010-ën.

Cilësia e portofolit të individëve do të përmirësohet thellësisht në 2010-ën me përfundimin e programit "Collection Excellence" i Raiffeisen International, i cili do të paraqesë strategji shumë të mira mbledhjeje të kredive me vonesë për të gjitha fazat e mos shlyerjes. Për më tepër, hartimi i një strategjie për mbledhjen e kredive me vonesë të Bizneseve të Vogla do të përfundojë në fillim të 2010-ës dhe do të implementohet nga mesi i vitit.

Njësia e verifikimit dhe aprovimit të kredive do të forcohet me prezantimin e scorecard-eve për retailin dhe me implementimin e sistemit të ri (APS).

Në përgjithësi, 2010 do të jetë një vit tranzicioni nga ngadalësimi i kreditimit gjatë krizës globale në forcimin e ekonomisë në 2011-ën dhe rikthimin në aktivitetin normal të huadhënies.

Departamenti i Zhvillimit të Rrjetit

Gjatë vitit 2009, Zhvillimi i Rrjetit u përqëndrua në zgjerimin e biznesit të POS-eve (Pikave të Shitjes), në forcimin e rrjetit të degëve dhe krijimin e kanaleve elektronike alternative për zhvillim në të ardhmen.

Zhvillimi i shërbimit Raiffeisen Direkt, Internet Banking dhe SMS Banking, nisi në 2009-ën dhe do të përfundojë në fillimet e 2010-ës. U arritën standarde të reja degësh, duke ndjekur linjat e Raiffeisen International dhe do të implementohen gradualisht në disa nga degët tona më të mëdha, duke përfshirë rimobilime, degë të reja dhe të ripozicionuara në 2010-ën. Ne vazhdojmë të jemi kryesues të fortë në treg, për sa i përket rrjetit tonë, me mbi 100 degë dhe më shumë se 180 ATM (dyfishi i konkurentit më të afërt në treg). Ne rritëm rrjetin tonë të POS-eve në rreth 1200 terminale në 2009-ën, duke ruajtur pozicionin kryesues në treg. Shërbimi i Call Centre ofrohet tani 24 orë në 7 ditë të javës duke u dhënë klientëve të të gjithë segmenteve mundësi të vazhdueshme, asitencë dhe informacion.

Rrjeti i Degëve

Për 2009 Raiffeisen Bank ka ruajtur pozitën e saj si banka më e madhe në Shqipëri përsa i përket mbulimit gjeografik me një rrjet prej mbi 100 degësh. Fokusi kryesor i bankës gjatë këtij viti nuk ka qenë rritja e prezencës së saj, por përmirësimi i rrjetit të krijuar, duke ripozicionuar degët në vende më të mira, apo duke zgjeruar hapësirën ekzistuese, në mënyrë që të ofrohen degë moderne dhe multifunkionale.

Gjatë vitit 2009 nga Raiffeisen International u prezantua Modeli i ri i Degeve dhe disa elementë të tij janë implementuar tashmë në shumë vende. Është hapur një dege e re dhe 6 të tjera u ripozicionuan apo u zgjeruan në 2009-ën.

Rrjeti i terminaleve POS

Gjatë vitit 2009 Raiffeisen Bank ka mbajtur dhe zhvilluar më tej rrjetin më të madh të POS-eve në vend. POS-et i ofrojnë klientëve tanë mundësinë për të përdorur kartat e tyre të debitit dhe të kreditit, Visa dhe MasterCard, për të kryer blerje në pikat e shitjes dhe gjithashtu për paradhënie Cash në degë. Pothuajse 1200 terminale POS kanë qenë në veprim deri në fund të vitit 2009,

23 prej tyre në degët (paradhënie cash). Rrjeti i POS-eve përfshin më shumë se 30 qytete që mbulojnë 65 kategori të ndryshme tregtarësh, duke përfshirë hotele, agjensi turistike, dyqane, restorante, pikat e karburantit dhe supermarketet. Paisjet tona me chip dhe disa wireless (pa tel) i ofrojnë tregëtarëve fjalën e fundit të teknologjisë dhe sigurinë e bankës kundër mashtrimeve. Përmirësimi i vazhdueshëm në mbështetjen dhe shërbimin ndaj tregëtarëve e kombinuar me zgjerimin e rrjetit që përputhet me rritjen e tregut, vazhdon të mbaje Raiffeisen Bank sërish në pozicion kryesues në treg.

Rrjeti ATM

Gjatë vitit 2009 Raiffeisen Bank vazhdoi të udhëheqë tregun bankar Shqiptar me mbi 180 ATM në të gjithë vendin, dyfishi i numrit të konkurrentit më të afërt. Paisjet tona ATM me chip pranojnë përdorimin e kartave VISA, VISA Electron, PLUS, MasterCard, Maestro dhe Cirrus pa kufizime për çdo vend ose bankë.

Në 2009 tërheqjet në monedhën Euro u ofruan në 23 ATM të pozicionuara në vende strategjike në të gjithë vendin, ku ekziston dhe nevoja më e lartë. Rrjeti i ATM-ve në Raiffeisen Bank mbetet i vetmi rrjet në Shqipëri i certifikuar plotësisht për EMV Chip për markat Visa dhe MasterCard, duke siguruar një avantazh të madh për Bankën dhe duke ju ofruar kartëmbajtësve nivel të lartë sigurie për transaksionet e tyre.

Call Centre


Call Centre i Raiffeisen bank është i organizuar në dy aktivitete kryesore, marrjen e thirrjeve për informacion, ndihmë dhe reagimet (përfshirë ankesat) dhe fushata shitjeje Telemarketing, anketime dhe mesazhe SMS.

Gjatë vitit 2009 Call Centre ka zgjeruar gamën e saj duke përfshirë suportin për Kartat dhe rrjetin e POS-eve. Në 2009 më shumë se 40 fushata Telemarketing janë kryer, të cilat kishin të bënë kryesisht me produktet e kredisë dhe norma interesi konkurruese për depozitat. Përdorimi i SMS u zgjerua nga lajmërimi për kreditimin e pages dhe për kreditime të tjera edhe për urime për festa, përgjigjet për ankesat e konsumatorëve, SMS për konsumatorët e Bizneseve të Vogla dhe mesazhe për Depozita me Afat, të reja dhe të rinovuara.

Zhvillimi i Segmenteve

Segmentet e Retail-it

Segmentet Retail janë zhvilluar më tej duke përdorur mënyra të ndryshme për t'iu afruar konsumatorit si një pjesë e rëndësishme e strategjisë Retail. Segmentimi i klientëve u zgjerua me prezantimin e shërbimeve bankare Premium brenda bazës së konsumatorëve me të ardhura mbi mesataren. Baza e konsumatorëve të Bizneseve të Vogla u rrit me forcimin e marrëdhënieve me klientët ekzistues dhe shtimit të konsumatorëve të rinj. Ritja e menaxhimit të marrëdhënieve me konsumatorët individë filloi me prezantimin e bazës së CRM-së (Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorin), planifikimit, analizës dhe shitjet e ndërthurura të cilat do të bëhen më të sofistikuar dhe të avancuara gjatë 2010.




Bizneset e Vogla

Segmenti Mikro është themeluar në 2009 si një biznes i rëndësishëm i bankës. Benefitet kryesor të segmentit janë tre avantazhe konkurruese të Raiffeisen: rrjeti më i madh i degëve në vend, procesim i shpejt i kredisë dhe kushte më të mira për klientët e Biznesit të Vogël. Dyzet menaxher të bizneseve të vogla janë vendosur në 30 degë.

për Biznes. Paketat bankare kanë si qëllim të zgjidhin nevojat e përditshme të biznesit dhe janë dizenuar në tre nivele: Bazë, Argjend dhe Ar. Paketat përfshinë llogarinë rrjedhëse, kartën e debiit, pagesat, transfertat, përdorimi i Call Centre, një menaxher të specializuar dhe përfitime të tjera. Portofoli i kredive për bizneset e Vogla është rritur me 14 milion Euro dhe llogaritë me 10.95 milion Euro. Segmenti tani ka 9.814 klientë, prej të cilëve 1.000 kanë një kontratë të kredie.

Produktet e kredive përfshijnë Overdraft (kredi kufi), Kredi për Investime, Kredi për Kapital Pune, Kredi Shumëfunktionale dhe Kredi Hipotekare

Segmenti i Bizneseve të vogla është një sektor i rëndësishëm ekonomik në Shqipëri, që përbën deri në 95% të të gjithë bizneseve. Në 2010 Raiffeisen Bank do të rrisë tregun e kreditimit duke u fokusuar te cilësia. Produktet dhe proceset e bizneseve të vogla do të përmirësohen për t’iu përgjigjur në kohë kërkesave të konsumatorëve me anë të aplikacionit të kredive. Bankingu Agrar do të fillojë me një program pilot në 2010 dhe pritet të rritet në mbështetje të segmenteve të bizneseve të vogla dhe të mesme.



Premium Banking

Premium Banking u prezantua gradualisht në 2009 në Tiranë dhe Fier, si zona pilot. Vlera që ju ofrohet klientëve nga ky segment është ofrimi i shërbimit të personalizuar dhe produkte për klientët tanë individë më të vlefshëm.

Klientëve Premium u janë caktuar bankiere të dedikuar. Ky shërbim përfshin një planifikim financiar të përshtatura për të përmbushur nevojat unike të çdo klienti. Në këtë prezantim gradual të Premium Banking, klientët reagojnë me entuziazëm duke e rritur më tej marrëdhënien e tyre me bankën. Një total prej 5.300 klientësh Premium kanë marrë një shërbim deri në fund të

2009. Portofoli i detyrimeve për Premium banking është rritur në tremujorin e fundit, duke arritur në 253.4 milion Euro deri në fund të vitit.

Premium banking do të prezantohet në shkallë kombëtare në 2010. Fokusi ndaj klientit do të vazhdojë të forcohet me zhvillimin dhe zbatimin e mjeteve Premium Banking CRM (Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin).

Kanalet e Shpërndarjes

Degët

Struktura e Rrjetit të Degëve u riorganizua në fund të vitit 2009 për të rritur efikasitetin dhe efikasitetin në menaxhimin e rrjetit të degëve. Numri i Zyrave Rajonale u ul nga 19 në 14; degët e bankës u organizuan në tre nivele bazuar në madhësinë e bazës së konsumatorëve dhe potencialin e biznesit, ku degët më të vogla janë nën varësinë e atyre më të mëdha nga ana operacionale. Drejtorët Rajonalë vazhdojnë të mbikqyrin menaxhimin e shitjeve në të gjitha degët për të siguruar qëndrueshmëri dhe cilësi.


Sistemi i menaxhimit të shitjeve në Raiffeisen (Efektiviteti i Forcës Shitëse) është zgjeruar nga vetëm në segmentin individë edhe në segmentin e bizneseve të mesme (SE). Në vitin 2010 ai do të zgjerohet më tej me segmentin e Bizneseve të Vogla (Micro). Një ri-freskim i praktikave të këtij sistemi menaxhimi shitje i provuar i suksesshëm, do të bëhet në të gjitha strukturat shitëse për të siguruar zbatimin e tij.

Cilësia e shërbimit ndaj klienteve mbetet një faktor i rëndësishëm konkures e diferencues për bankën Raiffeisen dhe do vazhdojë të ketë vëmendje të mëtejshme dhe përmirësime. Cilësia e Shërbimit ndaj klientit tashmë është në të njëjtin nivel me standartet e tregut shqiptar dhe qëllimi është që me kalimin e kohës të rrisim nivelin e shërbimit ndaj klientit drejt standarteve të Evropës Perëndimore. Kjo do të forcojë pozicionin udhëheqës së Bankës në sistemin bankar në Shqipëri dhe do të rrisë avantazhin tonë konkures në mënyrën me efektive.

Shitjet Direkte

Një Departament i ri i Shitjeve Direkte u krijua për të forcuar programin e shitjeve nga jashtë bankës. Brenda gjysmës së parë të vitit 2010, Raiffeisen Bank do të ketë një forcë shitëse të komisionuar plotësisht operacionale, e cila do drejtojë raste referimesh të para-kualifikuara sipas kushteve të bankës drejt rrjetit të degëve. Fokusi do të jetë në produktet e segmentit të Individëve dhe segmentit të Bizneseve të Vogla.

Banka Raiffeisen është udhëheqëse absolute në treg për Financimin e produkteve në dyqanet e Shitjeve me Pakicë (Retail Sales Finance), me staf prezent dhe proces kreditimi në dyqanet më të mëdha të shitjeve me pakicë në treg. Kreditë mund të miratohen brenda 30 minutash në shumicën e rasteve, duke i lejuar konsumatorët që në visitën e tyre të parë në dyqan, pas përfundimit të procesit të kredisë të largohen nga dyqani me mallrat e zgjedhura prej tyre.



Aleksandër Moisiu ishte një aktor Shqiptaro-Austriak me famë. Repertori i roleve të tij eklipsoi të gjithë spektrin e dramës Europiane nga tragjeditë Greke tek pjesët moderne të shekullit të 20-të. Ai ishte i pari në Europë që interpretoi karaktere të Strindbergut, Tolstoit, Çehovit dhe Hofmanshtalit.

"Timbri dhe gjestikulacionet e Moisiut na kanë shfaqur diçka të paparë deri më sot." – Franc Kafka
"Një Jugor, gjithmonë Jugor tipik. Për të mos qenë i ftohtë ai kudo që shkon merr me vete rrezatimin e vendit të tij. Kudo që të jesh me të do të mësosh diçka të re nga jeta në këtë botë." – Stefan Cvaaj

Thesari dhe Bankingu i Investimeve

Të ardhurat fikse

Raiffeisen BANK vazhdon të jetë investuesi kryesor në tregun e letrave me vlerë të emetuara nga qeveria e Shqipërisë. Banka jonë ka një përqindje të lartë pjesmarrjeje në tregun primar të letrave me vlerë, veçanërisht në obligacione thesari, duke iu ofruar shërbimin më të mirë klientëve të saj brenda dhe jashtë vendit.

Ne zotërojmë rreth 34% të tregut të Bonove të Thesarit dhe 55% të obligacioneve të Thesarit të emetuara nga qeveria e Shqipërisë. Raiffeisen BANK ka qenë aktive në tregtimin e obligacioneve në tregun me pakicë dhe atë sekondar, përgjatë vitit 2009. Portofoli i Raiffeisen BANK përbëhet nga portofoli i tregtueshëm dhe ai deri në maturim. Gjatë vitit 2009 kemi rritur kryesisht portofolin e tregtueshëm duke e pasuruar atë me letra me vlerë të maturimeve të ndryshme.

Në fund të muajit Dhjetor 2009, portofoli ynë i tregtueshëm ishte rreth 264.12 milionë Euro. Gjatë vitit 2009 vazhduam të fokusoheshim në letra me vlerë afatgjata, dhe kjo ka pasqyruar ndryshime të rëndësishme në strukturën tonë të letrave me vlerë, ku ato afatgjata (Obligacione me maturim 2, 3, 5 dhe 7 vjeçar) përbëjnë rreth 72% të portofolit të investimeve në Dhjetor 2009. Ne jemi krenar sepse jemi e vetmja bankë që jep një kontribut shumë të konsiderueshëm në tregun me pakicë të bonove të thesarit duke tregtuar (shitje dhe blerje) me klientë individë. Ky aktivitet kryhet në të gjitha degët tona. Transaksionet në tregun me pakicë kryhen jo vetëm me klientë individë por edhe me ata korporata e SME.

Ne vazhdojmë të kryejmë edhe aktivitetin e mbajtjes së regjistrit të letrave me vlerë të emetuara nga qeveria e Shqipërisë duke lejuar edhe investitorët e huaj të marrin pjesë në tregun tonë të letrave me vlerë.

Këmbimet valutore

Viti 2009 ishte një vit i vështirë për njësinë e Këmbimeve Valutore. Kriza financiare globale e cila preku edhe Shqipërinë pati shumë pasoja në luhatshmërinë e kurseve të këmbimit. Kështu gjatë vitit 2009 monedha vendase pësoi një zhvlerësim të lartë kundrejt monedhës europiane, Euro. Brenda një viti Leku Shqiptar humbi më tepër se sa 15 pikë.

Njësia e Këmbimeve Valutore bëri përpjekje të mëdha për të mbështetur tregun lokal duke kuotuar me çmime shumë konkurruese Njësinë e Shitjeve dhe tregun interbankar. Volumet janë rritur krahasuar me vitin 2008, duke arritur mesatarisht 200 million Euro, pjesa më e madhe e të cilës vjen nga transaksionet Euro/Dollar Amerikan. Gjithashtu numri i transaksioneve ndërbankare arriti në 180 marrëveshje në muaj.


Tregu i parasë

Viti 2009 pasoi krizën financiare ndërkombëtare të filluar në 2008 dhe njësia e Tregut të Parasë arriti të drejtojë sa më mirë situatën e likuiditetit, pavarësisht gjendjes së vështirë. Kjo njësi jo vetëm që ka mbajtur në të njëjtin nivel por është përpjekur të rrisë më tej volumin e transaksioneve si në tregun vendas ashtu dhe në atë ndërkombëtar. Kuotimet preferenciale për Njësinë e Shitjeve kanë ndihmuar njësinë e Tregut të Parasë të mbajë të qëndrueshëm likuiditetin afatshkurtër në mënyrë që të përmbushë edhe nevojat e bankës për të.

Siç dihet tregjet janë bërë më komplekse krahasuar me vitet e mëparshme, dhe Njësia e Tregut të Parasë ka qenë pjesë e këtyre ndryshimeve që po ndikojnë edhe tregun vendas, kjo njësi ka rritur volumin e transaksioneve dhe sigurisht ka diversifikuar me tëj produktet e saj. Njësia e Tregut të Parasë përditëson vazhdimisht kuotimet e saj, në mënyrë për të qënë pjesë e panelit të bankave që zgjidhen për publikimin e TRIBID/TRIBOR. Këto kuotime luajnë një rol kyç për këtë njësi, dhe bëjnë që Raiffeisen BANK të jetë një prej kontribuesve kryesorë të zgjedhur nga Banka e Shqipërisë.

Njësia e Shitjes

Gjatë vitit 2009, përsa i takon transaksioneve me klientët, Njësia e Shites pranë Divizionit të Thesarit u përball me vështirësitë e shkaktuara nga kriza financiare globale. Në krahasim me vitin 2008, xhiroja totale me klientët ishte më e ulët. Arsyeja për këtë ulje të volumit të transaksioneve ishte pikërisht kriza financiare e cila preku edhe ekonominë shqipëtare. Monedha vendase u zhvlerësua më shumë se sa 10 % gjatë vitit 2009. Duke marrë parasysh faktin se ekonomia shqipëtare është bazuar shumë mbi importin, zhvlerësimi i monedhës lokale ishte një nga arsyet që volumi i transaksioneve me klientet pësoi ulje. Megjithatë, Njësia e Shitjes pranë Divizionit të Thesarit, u përpoq që të ruante pozicionin e saj në treg duke u fokusuar përsëri te nevojat e klientit, në bashkpunim shumë të ngushtë me të treja njësitë brenda Dealing Room. Njësia e shitjeve u përpoq që të ndihmonte klientet duke i konsultuar ata dhe duke ndërtuar një marrëdhënie më të fortë, një faktor i rëndësishëm gjatë krizës financiare.



Emri i tij i lindjes është Mustafa, ndërsa emri i tij i dytë Kemal (dmth Pjekuri ose Përsosmëri) iu dha nga mësuesi i tij i matematikës, si vlerësim ndaj aftësive të shkëlqyera akademike. Ai arriti të transformonte Perandorinë e dikurshme Osmane, në shtet laik modern dhe demokratik. Atatürku ndër morri një program reformash ekonomike, politike dhe kulturore.

Babai i Mustafait ishte Shqipëtar, dhe nëna Maqedonase.

Raporti i Audituesve të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Përmbajtja

Raporti i Audituesve të Pavarur	39
<hr/>	
Pasqyrat Financiare të Konsoliduara:	
Pasqyra e Konsoliduar e pozicionit financiar	41
Pasqyra e Konsoliduar përmbledhëse e të ardhurave	42
Pasqyra e Konsoliduar e ndryshimeve në kapital	43
Pasqyra e Konsoliduar rrjedhjes së parasë	44
<hr/>	
Shënime për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara	45-88
<hr/>	



Deloitte Albania Sh.p.k.
Rr. Elbasanit Pall. Poshte
Fakultetit Gjeologji - Miniera
Tirana
Tel: +355 4 4517 920
Fax: +355 4 4517 990
www.deloide.com/al

Raporti i audituesve të pavarur

Për Aksionerët e Raiffeisen Bank SHA

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Raiffeisen Bank SHA ("Grupi"), që përbajnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2009 dhe pasqyrën e konsoliduar përmbledhëse të të ardhurave, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve të kapitalit, pasqyrën e konsoliduar të rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur më këtë datë si dhe një përmbledhje të politikave kontabël kryesore dhe të tjera shënime sqaruese. Pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më datë 31 Dhjetor 2008 janë audituar nga një tjetër kompani auditimi, raporti i auditimit i të cilës, më datë 5 Maj 2009, shpreh një opinion të pakualifikuar mbi pasqyrat financiare të konsoliduara.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara të cilat nuk përbajnë pasaktësi materiale, qoftë si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve; zgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël të përshtatshme; si dhe kryerjen vlerësimeve kontabël të arsyeshme sipas rrethanave.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara bazuar në auditimin tonë. Ne kyem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhje me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë një siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të konsoliduara nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të pasaktësive materiale, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve. Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara të Shoqërisë në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe pranueshmërisë së vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin në mënyrë drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më 31 Dhjetor 2009, rezultatit financiar dhe rrjedhjen e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte Albania shpk

Tiranë, Shqipëri
12 Mars 2010

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu, as Swiss Verein, and its network of member firms, each of which is legally separate and independent entity, please see <http://www.deloitte.com/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu and its member firms.

For a detailed description of the legal structure of Deloitte Albania and its member firms. Please see <http://www.deloitte.com/al/about>
Member of Deloitte Touche Tohmatsu

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2009	31 Dhjetor 2008
Aktivët			
Para dhe ekuivalentët e saj	7	11,220,360	6,563,688
Shuma të kushtëzuara	8	20,345,307	22,279,752
Investime të mbajtura për tregtim	9.1	36,524,191	21,877,289
Investime të mbajtura deri në maturim	9.2	93,189,711	115,992,749
Hua dhe paradhënie për klientët	10	88,328,640	83,374,927
Aktive afatgjata materiale	11	1,647,341	1,978,504
Aktive afatgjata jomateriale	11	311,388	309,312
Investime në kapital	12	19,734	10,859
Emër i mirë		92,783	-
Tatim fitimi i parapaguar		163,374	319,749
Aktive të tjera	13	1,359,931	882,433
Totali i aktiveve		253,202,760	253,589,262
Detyrimet			
Detyrime ndaj institucioneve financiare	14	2,197,145	3,151,021
Marrëveshje të anasjallta të riblerjes	15	17,945,088	11,395,040
Detyrime ndaj klientëve	16	207,628,047	216,067,206
Tatimi i shtyrë	17	202,464	167,923
Detyrime të tjera	18	728,593	3,003,242
Totali i detyrimeve		228,701,337	233,784,431
Kapitali			
Kapitali aksionar		4,348,233	
Rezerva e përgjithshme		2,800,000	4,348,233
Rezerva e rivlerësimit	19	19,734	850,000
Fitimi i pashpërndarë	20	17,281,448	14,561,739
Totali i kapitalit që i përket aksionerëve të Bankës		24,449,415	19,759,972
Interesat jo kontrolluese	21	52,008	38,668
Totali i kapitalit aksioner		24,501,423	19,798,640
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksioner		253,202,760	253,583,072

Këto pasqyra financiare të konsoliduara u miratuan nga Këshilli Mbikqyrës më 5 mars 2010 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Oliver Whittle
Drejtor i Përgjithshëm



Alda Shehu
Drejtoreshë e Divizionit të Financës

Bilanci i konsoliduar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 45 deri në faqen 88, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar përmbledhëse e të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009
(të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008
Të ardhura nga interesat	22	19,300,170	18,996,544
Shpenzime për interesa	23	(8,524,410)	(8,954,111)
Të ardhura neto nga interesat		10,775,760	10,042,433
Të ardhura nga komisionet	24	1,329,167	1,662,109
Shpenzime për komisionet		(215,182)	(306,269)
Të ardhura neto nga komisionet		1,113,985	1,355,840
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë		-	10,199
Fitimi neto nga tregëtimi		1,226,968	1,129,358
Të ardhura/(shpenzime) të tjera operative, neto	25	173,621	(275,384)
		1,400,589	864,173
Primi i sigurimit të depozitave	26	(409,561)	(414,868)
Shpenzime për personelin	27	(1,743,173)	(1,946,664)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11	(621,712)	(638,749)
Shpenzime të përgjithshme administrative	28	(1,486,548)	(1,876,718)
Humbje neto nga zhvlerësimi i huave	10	(3,788,377)	(1,690,037)
		(8,049,371)	(6,567,036)
Fitimi para tatimit		5,240,963	5,695,410
Tatimi mbi fitimin	29	(547,056)	(600,550)
Fitimi neto për vitin		4,693,907	5,094,860
Të ardhura të tjera përmbledhëse			
Rezerva e vlerës së drejtë (aktive financiare të disponueshme për shitje)			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë		8,875	10,859
Total i të ardhurave përmbledhëse		4,702,782	5,105,719
I përket:			
Aksionarëve të Bankës		4,680,568	5,082,871
Interesave jo kontrolluese		13,339	11,989

Bilanci i konsoliduar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 45 deri në faqen 88, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009
(të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

	Kapitali aksioner	Rezervat e përgjithshme	Rezerva e rivlerësimit	Fitimimi i pashpërndarë	Totali	Interesat jo kontrolluese	Totali i kapitalit
Gjendja më 31 Dhjetor 2007	4,348,233	850,000	-	10,167,732	15,365,965	26,679	15,392,644
Dividend i paguar	-	-	-	(699,722)	(699,722)	-	(699,722)
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	10,859	-	10,859	-	10,859
Fitimi neto për vitin	-	-	-	5,082,871	5,082,870	11,990	5,094,860
Gjendja më 31 Dhjetor 2008	4,348,233	850,000	10,859	14,550,880	19,759,972	38,669	19,798,641
Transferimi i fitimit të pashpërndarë në rezervën e përgjithshme	-	1,950,000	-	(1,950,000)	-	-	-
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	8,875	-	8,875	-	8,875
Fitimi neto për vitin	-	-	-	4,680,568	4,680,568	13,339	4,693,907
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	4,348,233	2,800,000	19,734	17,281,448	24,449,415	52,008	24,501,423

Bilanci i konsoliduar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 45 deri në faqen 88, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009
(të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2008
Rrjedhja e parasë nga operacionet		
Fitimi para tatimit	5,240,963	5,695,410
Zëra jo-monetarë në pasqyrën e të ardhurave		
Zhvlrësimi dhe amortizimi	621,712	638,749
Aktivet e qëndrueshme të nxjerra jashtë përdorimi	66,892	20,858
Humbje neto nga zhvlrësimi i aktiveve financiare	3,788,377	1,690,037
Të ardhurat neto nga interes	(10,775,760)	(10,042,433)
Ndryshimi në provigjione për debitorë të tjerë	(190,562)	145,962
	(1,248,378)	(1,851,417)
Pakësim / (rritje) në shuma të kushtëzuara	1,934,663	(1,668,958)
Rritje në hua dhe paradhënie për klientët	(8,401,766)	(23,179,691)
Rritje në REPO të anasjalltë/REPO	6,497,528	11,345,546
Rritje në letra me vlerë të tregtueshme	(14,646,902)	(21,815,770)
Rritje në aktive të tjera dhe emër të mirë	(470,580)	(370,125)
(Pakësim) / rritje në detyrimet ndaj institucioneve financiare	(978,839)	740,087
Pakësim në detyrimet ndaj klientëve	(7,322,434)	(3,787,102)
(Pakësim) / rritje në pasivet e tjera	(2,084,270)	1,651,945
	(26,720,978)	(38,935,485)
Interesi i arkëtuar	19,086,033	17,920,233
Interesi i paguar	(9,563,650)	(7,629,620)
Tatimi i paguar mbi fitimin	(461,846)	(831,162)
Paraja neto e përdorur nga aktivitetet operacionale	(17,660,441)	(29,476,034)
Rrjedhja e parasë nga investimet		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(224,258)	(604,778)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	(135,263)	(168,155)
Maturimi i letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim	22,676,634	7,697,345
Rrjedhja e parasë neto e gjeneruar nga investimet	22,317,113	6,924,412
Rrjedhja e parasë nga financimet		
Dividend i paguar nga fitimi i pashpërndarë i vitit të kaluar	-	(699,722)
Rrjedhja e parasë neto e përdorur në financime	-	(699,722)
Rritje / (pakësimi) neto në para dhe ekuivalentët e saj	4,656,672	(23,251,344)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit (shënimi 7)	6,563,688	29,815,034
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit (shënimi 7)	11,220,360	6,563,688

Bilanci i konsoliduar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 45 deri në faqen 88, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. Të përgjithshme

Raiffeisen Bank SHA ("Banka") është emri që Banka mori duke filluar nga data 1 Tetor 2004 nga ish Banka e Kursimeve sh.a. Banka e Kursimeve u krijua në vitin 1991 nga ndarja e ish "Instituti të Sigurimeve dhe Arkave të Kursimit" me qëllim administrimin e depozitave të individëve dhe ndërmarrjeve, dhënien dhe administrimin e huave për individët, ndërmarrjet dhe subjektet shtetërore, si dhe për kryerjen e shërbimeve të ndryshme bankare.

Më 11 Dhjetor 1992, Banka u regjistrua për të vepruar si Bankë në Republikën e Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr.7560 "Për sistemin Bankar në Shqipëri". Banka e Shqipërisë i dha Bankës së Kursimeve një licensë të përgjithshme, të patransferueshme dhe të pakufizuar në kohë. Më 27 Korrik 1997, në përputhje me Vendimin Nr.17426 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Banka u shndërrua në një Shoqëri me Kapital Aksionar. Aksionari i vetëm i Bankës ishte Ministria e Financës me një kapital fillestar prej 700 milion Lek, i cili përbëhej nga 7,000 aksione me vlerë nominale 100,000 Lek për çdo aksion. Në bazë të këtij vendimi, Banka e Shqipërisë më 11 Janar 1999 rinovoi licensën e bankës për të pasqyruar këto ndryshime.

Më 14 Prill 2004, Ministria e Financës së Shqipërisë i shiti Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft (RZB AG) 100% të aksioneve të emetuara dhe në funksionim të bankës.

Më 21 Korrik 2004, RZB AG kaloi 100% të aksioneve në filialin krejtësisht në pronësi të RZB AG, Raiffeisen International AG, Vienna, Austria, i cili është tani aksionari i 100% të aksioneve të emetuara dhe në funksionim të bankës.

Më 28 Prill 2006 Banka dhe RLI themeluan Raiffeisen Leasing Sh.a. Banka zotëron 75% të aksioneve të kompanisë. Më 15 Janar 2009 Banka mori në pronësi 100% të aksioneve të Instituti Amerikan të Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë, sipas kontratës së shitblerjes së aksioneve të datës 26 Dhjetor 2008. Më 23 Prill 2009 emri i këtij të fundit ndryshoi në Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a.

Pasqyrat e konsoliduara financiare të Grupit më 31 Dhjetor 2009 përfshijnë Bankën, Raiffeisen Leasing Sh.a dhe Raiffeisen Pensions sh.a (së bashku "Grupi") dhe më 31 Dhjetor 2008 përfshijnë Bankën dhe Raiffeisen Leasing Sh.a.

Më 31 Dhjetor 2009, Banka operon me një rrjet bankar prej 102 pika shërbimi nëpër të gjithë Shqipërinë (më 31 Dhjetor 2008: 100 pika shërbimi), të cilat drejtohen nga 20 Degë Rajonale.

Drejtesit dhe Administratorët më 31 Dhjetor 2009 dhe 2008:

Këshilli Drejtues (Këshilli Mbikqyrës)	
Heinz Höedl	Kryetar
Herbert Stepic	Anëtar
Peter Lennkh	Anëtar
Martin Grill	Anëtar
Aris Bogdaneris	Anëtar
Komiteti i Kontrollit	
Heinz Hödl	Kryetar
Johannes Kellner	Anëtar
Susana Mitter	Anëtar
Bordi Drejtues	
Oliver J. Whittle	Drejtor i Përgjithshëm
Christian Canacaris	Anëtar
Peter Hakkenberg	Anëtar
Robert Wright	Anëtar (larguar nga Banka më 30 qershor 2009)

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe interpretimet e tyre të përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

(b) Baza e matjese

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç sa më poshtë:

- Instrumentet derivative financiare janë matur me vlerë të drejtë,
- Instrumentet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitim humbjes janë matur me vlerë të drejtë,
- Aktivitetet financiare të disponueshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Grupit. Përveç rasteve ku tregohet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në Lek është rumbullakosur në mijëshen më të afërt.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga vlerësimet.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në Shënimin 4.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Polikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Polikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga entitetet e Grupit

(a) Bazat e konsolidimit

(i) Kombinimi i bizneseve

Në përputhje me SNRF 3 "Kombinimi i bizneseve", një kombinim biznesi është bashkimi i entiteve ose bizneseve të veçanta në të njëjtin entitet raportues. Nëse transaksioni përmbush kriterin e kombinimit të bizneseve, duhet të përcaktohet nëse kombinimi i bizneseve përfshin entitete nën të njëjtin kontroll. Në përputhje me SNRF 3, dy entitete janë nën kontroll të përbashkët, kur entitetet ose bizneset e kombinuara kontrollohen nga e njëjta palë (palët) si para edhe pas kombinimit të biznesit dhe kur kontrolli nuk është i përkohshëm (kalimtar).

Kombinimet e biznesit janë kontabilizuar duke përdorur metodën e përvetësimit në datën e përvetësimit, e cila është data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Kontrolli është aftësia për të udhëhequr politikat financiare dhe operative të një entiteti, pra për të siguruar përfitime nga aktivitetet e tij. Për vlerësimin e kontrollit, Grupi merr në konsideratë të drejtat e mundshme të votës, të cilat janë aktualisht të ushtrueshme. Emri i mirë është tejkalimi i kostos së përvetësimit nga Grupi përtej interesit të Grupit në vlerën (zakonisht vlera e drejtë) e aktiveve, detyrimeve dhe detyrimeve të mundshme të identifikueshme të entitetit që përvetësohet.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

(ii) Filialet

Filialet janë entitete të cilat kontrollohen nga Grupi. Kontrolli ekziston atëherë kur Grupi në mënyrë direkte ose indirekte ka fuqi të drejtojnë politikat financiare dhe operative të një entiteti në mënyrë të tillë që të përfitojë të mira nga aktivitetet e tij. Për të vlerësuar kontrollin, merren në konsideratë të drejtat për të votuar të cilat janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Pasqyrat financiare të filialeve janë përfshirë në pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të kontrollit deri në datën e përfundimit të tij.

Grupi përgatit pasqyra financiare të konsoliduara dhe të veçanta në përputhje me SNRF dhe periudha raportuese është e njëjtë për të gjitha kompanitë e grupit.

(iii) Eliminimi i transaksioneve gjatë konsolidimit

Balancat brenda Grupit dhe të ardhurat dhe shpenzimet e përcaktuara që lindin nga transaksionet brenda Grupit, eliminohen gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e përcaktuara eliminohen në të njëjtën mënyrë si të ardhurat e përcaktuara, por deri në masën që nuk ka të dhëna për zhvlerësim.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të pasqyrës së pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të vitit. Aktivitetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhën funksionale me kursin e datës së caktimit të vlerës reale. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktivitetit dhe detyrimit financiar dhe nuk ka rishikim të mëvonshëm.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, të cilat janë një pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesat nga aktivitetet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e normës së interesit efektiv si dhe interesat nga letrat me vlerë të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

(d) Tarifa dhe Komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat, duke përmendur këtu tarifat e shërbimeve kontabël, komisionet e shitjeve, tarifa të depozitave njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to. Shpenzime të tjera nga komisionet dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

(e) Të ardhurat neto nga tregëtimi

Të ardhurat neto nga tregëtimi përfshijnë fitimet minus humbje të lidhura me aktivet dhe detyrimet e tregtueshme, dhe gjithashtu të gjitha ndryshimet në vlerë të drejtë, të realizuara ose jo, interesin, dividendët dhe ndryshimet nga kurset e këmbimit.

(f) Pagesat e qirasë dhe shpenzime të tjera operative

Pagesat e bëra nën qiranë operative janë njohur në të ardhura dhe shpenzime në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Zbritje nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë gjatë jetës së qirasë.

Shpenzimet operative regjistrohen atëherë kur ato ndodhin.

(g) Përfitimet e punonjësve

- *Plan pensioni me kontribute të përcaktuara*

Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin. Grupi paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuar për pensione.

- *Leja vjetore e paguar*

Grupi njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostos së vlerësuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

- *Përfitime afat-shkurtra*

Detyrimet për përfitime afatshkurtra nuk skontojnë dhe regjistrohen në periudhën kur ofrohet shërbimi. Një provigjon mund të regjistrohet për shumën që pritet të paguhet në lidhje me bonuset afatshkurtra në para ose planet e pjesëmarrjes në fitime, nëse Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi, dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

- *Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës*

Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës regjistrohen atëherë kur Grupi në mënyrë të dukshme ka vendosur të zbatojë një plan formal të detajuar për të ndërprerë punësimin para datës së daljes në pension. Përfitime të ofruara për largimin vullnetar do të regjistrohen vetëm atëherë kur oferta është bërë, është e mundshme që do të pranohet, dhe numri i personave që do të pranojnë ofertën mund të matet në mënyrë të besueshme.

(h) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore të prishme në datën kur diferencat e përkohshme do të rimerren, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferenca tatimore të zbritshme të mund të përdoren. Një pasiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivi tatimor i shtyrë dhe pasivi tatimor i shtyrë rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen për aq sa nuk është e mundur të realizohet respektivisht përfitimi apo detyrimi fiskal i lidhur me të. Taksa të tjera shtesë lidhur me dividendin njihen kur njihet edhe detyrimi për pagimin e dividendit. Taksa të tjera shtesë lidhur me dividendin njihen kur njihet edhe detyrimi për pagimin e dividendit.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

(i) Aktivet dhe detyrimet financiare

i Njohja

Huatë dhe parapagimet dhe depozitat njihen fillimisht me kosto në datën e origjinës. Të gjitha aktivet financiare të tjera fillimisht njihen në datën e tregtimit, datë në të cilën Grupi bëhet palë e kontratës.

ii Ç'rregjistrimi

Aktivët financiarë ç'rregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Grupit ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivi financiar mbarojnë, ose nëse Grupi i transferon aktivin financiar një pale tjetër, përmes një transaksioni ku të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivit transferohen. Çdo interes në aktive financiare të transferuara që përfitohet ose i mbahet Grupit njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare ç'rregjistrohen nëse detyrimet e Grupit të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Grupi merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha risqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivet e transferuara nuk ç'rregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha risqet dhe përfitimet përfshin huadhënien e letrave me vlerë, dhe transaksionet e riblerjeve.

Kur aktivet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi në këmbim ('swap'), transaksioni konsiderohet si një transaksion financiar i siguruar i ngjashëm me transaksionet e riblerjes.

Në transaksione në të cilat Grupi as nuk mban dhe as nuk transferon risqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivet financiare, e çregjiston aktivin nëse kontrolli mbi të humbet.

Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transferim janë të njohura më vete si aktive ose detyrime sipas rastit.

Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli Grupi vazhdon ta njohë aktivin deri në momentin e përfshirjes së tij të vazhdueshme, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Grupi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivit të transferuar.

iii Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

iv Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuar të tregut ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiare të tregtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi.

Grupi përdor gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiare të zakonshme e të thjeshta si opsionet, swap-et e normave të interesit dhe të monedhës. Për të tilla instrumenta të dhënat për tu përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

v Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Grupi ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtues të Grupit.

vi Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Grupi vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njëhjetës fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Grupi merr në konsideratë evidencat për zhvlerësim si për aktive specifike ashtu edhe në baza kolektive. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme trajtohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme të cilat specifikisht nuk kanë evidencë për zhvlerësim, trajtohen në grup për ndonjë zhvlerësim të ndodhur por të paidentifikuar ende. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshme trajtohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuara) me karakteristika të njëjta risku.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuar mund të përfshijnë mospagesa ose shkelje nga huamarrësit, ristrukturimin e një huaje, të dhëna që një huamarrës po falimenton, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si për shembull ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të një huamarrësi, ose kushte ekonomike që tregojnë për mospagime.

Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Grupi përdor modelimin statistikor të trendave historike të propabilitetit të mospagimit, përcaktimin e kohës së rimarrjeve dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin manaxherial nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Normat e mospagimeve, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rimarrjes krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme.

Humbjet nga zhvlerësimi të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuara llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, rimarrja e zhvlerësimit pasqyrohet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

vii Klasifikimi me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve

Grupi i klasifikon aktivet dhe detyrimet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve kur:

- Aktivet ose detyrimet trajtohen, vlerësohen dhe raportohen me vlerën e drejtë të tyre.
- Klasifikimi shmang ose ul në një masë të konsiderueshme një mospërputhje kontabël që në kushte të tjera do të ishte e pranishme.
- Aktivi ose detyrimi përmban një derivativ që modifikon në mënyrë të konsiderueshme flukset monetare që do të kërkoheshin në rast të kundërt mbi bazën e kushteve kontraktuale.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

(j) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, gjëndje të pakushtëzuara të Bankës Qendrore, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Grupi për administrimin e angazhimeve afat shkurtra.

Këto aktive mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

(k) Aktivet dhe detyrimet e tregtueshme

Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme janë ato aktive dhe detyrime që Grupi ka kryesisht për qëllimin e shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtër, ose i mban si pjesë e portofolit i cili përdoret për ruajtjen e pozicionit ose për përfitime afatshkurtra.

Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme, fillimisht njihen me kosto dhe më vonë mbahen me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar, duke i kaluar kostot e transaksionit si fitim ose humbje në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Çdo fitim ose humbje si pasojë e ndryshimit në vlerën e drejtë njihet si pjesë e "Të ardhura nga tregtimi". Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme nuk riklasifikohen pas rregjistrimit fillestar.

(l) Derivatët jo të tregëtueshme

Derivatët e mbajtura për qëllime të manaxhimit të riskut përfshijnë të gjitha aktivët dhe detyrimet derivative të cilat nuk janë të klasifikuara si aktive ose detyrime të tregtueshme. Derivatët maten me vlerë të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar. Kur një derivativ nuk është i tregtueshëm dhe nuk klasifikohet në një marrëdhënie hedge (mbrojtje) të kualifikuar, të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të tij njihen menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave si një përbërës i të ardhurave të tregimit.

Vlera e drejtë e swap-eve të normës së interesit është shuma e vlerësueshme që Grupi do të mund të përfitonte ose paguante për të përfunduar swap-in në datën e mbylljes së raportimit, duke marrë parasysh normat aktuale të interesit dhe besueshmërinë e homologëve të swap-it. Vlera e drejtë e kontratave të këmbimit të ardhshëm ('forward') të monedhave të huaja është çmimi i tyre i tregut në datën e raportimit, pra vlera aktuale e çmimeve të ardhshme ('forward') të kuotuar në treg.

(m) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativë, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Grupi nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër.

Kur Grupi është qiradhënës në një kontratë qiraje që transferon thuajse të gjitha reziqet dhe të mirat e lidhura me pronësinë e një aktivi tek një qiramarrës, marrëveshja prezantohet brenda huave dhe paradhënieve.

Kur Grupi blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kyesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivët në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Grupit.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(n) Letrat me vlerë

Investimi në letrat me vlerë matet me vlerën e tregut duke i shtuar kostot direkte të transaksionit dhe në vijim kontabilizohet mbi bazën e klasifikimit si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, ose të disponueshme për shitje.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

i Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë investime që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe për të cilat Grupi ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim, të cilat nuk janë klasifikuar si të disponueshme për shitje, apo me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe regjistrohen pas njohjes fillestare me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo shumë afër maturimit, do të çonte në riklasifikimin e të gjithë portofolit të mbajtur deri në maturim si investim i mbajtur për shitje dhe do ndalonte Grupin për klasifikimin e tyre si investim i mbajtur deri në maturim për periudhën aktuale dhe për dy vitet pasuese.

ii Me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve

Grupi mban disa letra me vlerë me vlerën e tregut, me ndryshimet në vlerë të njohura menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave siç përshkruhet në politikën kontabël 3(i)(vii).

iii Letra me vlerë të vlefshme për shitje

Investime të disponueshme për shitje janë investime jo-derivative të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Investimet në kapital të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, maten me kosto. Mjetet e tjera të disponueshme për shitje mbahen në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të tyre.

Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave sipas metodës së interesit efektiv. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen direkt në kapital deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, kur vlera progresive e njohur në kapital, kalon si fitim ose humbje në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

(o) Aktivitet e trupëzuara

i Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Grupi përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi, dhe kostot e çmontimit dhe kthimit të vendndodhjes në kushtet e duhura.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të konsoliduara të aktiveve afatgjata materiale.

ii Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Grup, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

iii Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me anën e metodës lineare gjatë jetës së çdo aktivi afatgjatë material. Aktivet e marra me qera zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Toka nuk zhvlerësohet.

Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si vijon

Kategoria	2009 (në vite)	2008 (në vite)
Ndërtesa	20	20
Kompjutera, ATM dhe pajisje informatike	4	4
Automjete	5	5
Investime në mjetet e marra me qira	2-4	2-4
Të tjera (Pajisje Zyre)	5	5

Jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit

(p) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale të blera nga Grupi njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi aktivët afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën aktivi është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e aktiveve afatgjata jomateriale është 4 vjet.

Shpenzimet e kërkimit, të kryera me qëllim përfitimin e një njohurie shkencore ose teknike regjistrohen si shpenzim në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(q) Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë burimet kryesore të financimit të Grupit.

Kur Grupi shet një aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-blerjeje për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Grupit.

Grupi klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(r) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbylltur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin.

Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është ulur apo nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin apo amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur më parë ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

(s) Provigjionet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjionet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para takse e cila reflekton vlerën e tregut, dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

(t) Standarde dhe interpretime efektive në periudhën aktuale

Rishikimet e mëposhtme për standardet ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar janë të vlefshme për periudhën aktuale:

- SNRF 8 “Segmentet Operative” (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2009 ose pas kësaj date),
- Rishikimi i SNRF 4 “Kontratat e Sigurimeve” dhe SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Paraqitja” – Përmirësimi i paraqitjeve rreth pasqyrave financiare (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2009 ose pas kësaj date). Përmirësimet e paraqitjeve të instrumentave financiare të aplikuara nga Banka janë paraqitur në shënimin 3 (v),
- Rishikimi i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF” dhe SNK 27 “Pasqyrat financiare të Konsoliduara dhe Individuale” – Kostoja e investimit në filiale, pjesëmarrje në sipërmarrjet e përbashkëta, ose pjesëmarrje (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2009 ose pas kësaj date),
- Ndryshimet në disa standarde dhe interpretime që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimet në cilësi të SNRF-ve, e publikuar më 22 Maj 2008 (SNK 1, SNRF 5, SNK 8, SNK 10, SNK 16, SNK 19, SNK 20, SNK 23, SNK 27, SNK 28, SNK 29, SNK 31, SNK 34, SNK 36, SNK 38, SNK 39, SNK 40, SNK 41) fillimisht me qëllim heqjen e paqëndrueshmërive dhe përmirësimin e tekstit (shumica e rishikimeve do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2009 ose pas kësaj date),
- Rishikimi i SNK 32 “Instrumentet Financiare: Paraqitja” dhe SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” – Instrumente financiare të kthyeshme dhe detyrimet që lindin nga falimentimi. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2009 ose pas kësaj date),
- SNK 1 (i rishikuar) “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” – Një paraqitje e rishikuar (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2009 ose pas kësaj date),
- SNK 23 (i rishikuar) “Kostot e Huamarrjes (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2009 ose pas kësaj date),

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

- Rishikim i SNRF 2 "Pagesa të Bazuara në Aksione" – Kushtet e fiksuara dhe anulimet (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2009 ose pas kësaj date),
- Rishikim i KIRFN 9 "Rivlerësim i derivativëve të përfshirë" dhe SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja" - Derivativë të përfshirë (e vlefshme për periudhat vjetore që përfundojnë më 30 Qershor 2009 ose pas kësaj date),
- KIRFN 13 "Programet e Besnikërisë së Klientëve" (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2008 ose pas kësaj date),
- KIRFN 15 "Marrëveshjet për Ndërtimin e Pasurive të Patundshme" (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2009 ose pas kësaj date),
- KIRFN 16 "Mbrojtjet e një Investimi Neto në një Njësi Ekonomike të Huaj" (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Tetor 2008 ose pas kësaj date),
Aplikimi i këtyre rishikimeve dhe standardeve e interpretimeve ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Grupit.

(u) Standarde dhe interpretime të publikuara akoma të pa-miratuara

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar, por ende jo në fuqi:

- SNRF 9 "Instrumentet Financiare" (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2013 ose pas kësaj date),
- SNRF 3 (i rishikuar) "Kombinimet e Biznesit" (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- SNRF 1 (i rishikuar) "Aplikimi për herë të parë i SNRF" (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
 - Rishikim i SNRF 1 "Aplikimi për herë të parë i SNRF" – Përfshirjet shtesë për herën e parë të zbatimit. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),
- Rishikim i SNRF 1 "Aplikimi për herë të parë i SNRF"- Përfshirjet e limituara për shifrat krahasuese sipas SNRF 7, për paraqitjet për herën e parë të zbatimit. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date),
- Rishikim i SNRF 2 "Pagesa të Bazuara në Aksione" – Transaksionet me bazë aksionesh të shlyera në mjete monetare brenda grupit (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),
- Rishikim i SNK 24 "Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Palët e Lidhura" – Thjeshtësimi i kërkesave për paraqitjet e entiteteve të lidhura me qeverinë dhe qartësimi i përkufizimit të palëve të lidhura. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2011 ose pas kësaj date),
- Rishikimi i SNK 27 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale" (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- Rishikim i SNK 32 "Instrumentet Financiare: Paraqitja" – Kontabilizimi i emetimit të të drejtave (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Shkurt 2010 ose pas kësaj date),
- Rishikim i SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja" – Zëra të mbrojtur të pranueshëm. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- Ndryshimet në disa standarde dhe interpretime që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimet në cilësi të SNRF-ve të publikuara më 16 Prill 2009 (SNRF 2, SNRF 5, SNRF 8, SNK 1, SNK 7, SNK 17, SNK 18, SNK 36,

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

SNK 38, SNK 39, KIRFN 9, KIRFN 16) fillimisht me qëllim heqjen e paqëndrueshmërive dhe përmirësimin e tekstit (shumica e rishikimeve do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),

- Rishikim i KIRFN 14 “SNK 19 — Limiti mbi aktivin për përfitimin e përcaktuar, Kërkesat minimale për fonde dhe ndërveprimet e tyre. – Parapagimet e një minimumi të kërkesës për fonde (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2011 ose pas kësaj date),
- KIRFN 17 “Shpërndarja e Aktiveve Jo-monetare ndaj Pronarëve” (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- KIRFN 18 “Transferimi i Aktiveve nga Klientët” (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- KIRFN 19 “Shuarja e Detyrimeve me instrumente Kapitali” (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date).

Grupi ka zgjedhur të mos aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Grupi parashikon se adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat e tij financiare të konsoliduara në periudhën e aplikimit fillestar.

(v) Zhvillime të tjera kontabël

Banka ka aplikuar përmirësimet e paraqitjeve të instrumentave financiare (përmirësimet e SNRF 7), të publikuara në mars 2009, të cilat kërkojnë shtesa në paraqitjet e matjes së vlerës së drejtë dhe rrezikut të likuiditetit në lidhje me instrumentat financiare.

Përmirësimet kërkojnë që paraqitjet e matjes së vlerës së drejtë të përdorin një hierarki me tre nivele të vlerës së drejtë, e cila reflekton rëndësinë e të dhënave të përdorura në matjen e vlerës së drejtë të instrumentave financiare. Paraqitje të veçanta kërkojnë kur matjet e vlerës së drejtë janë kategorizuar në nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë. Ndryshimet kërkojnë që çdo transferim i rëndësishëm nga niveli 1 dhe niveli 2 i hierarkisë së vlerës së drejtë të paraqitet veçmas, duke bërë dallime nëpërmjet transferimeve brenda dhe jashtë secilit nivel. Për më tepër ndryshimet në teknikat e vlerësimit nga njëra periudhë në tjetrën, duke përfshirë edhe arsyet, nevojiten të paraqiten për secilën klasë të instrumentave financiare. Paraqitjet e rishikuara lidhur me vlerën e drejtë të instrumentave financiare janë paraqitur në shënimin 4.

Më tej, përkufizimi i rrezikut të likuiditetit ka ndryshuar dhe tashmë përcaktohet si rreziku që një shoqëri do të përballojë vështirësi të lidhura me detyrimet financiare që shlyhen përmes pagesave në para, ose aktive të tjera financiare.

Ndryshimet kërkojnë paraqitjen e një analize maturiteti për detyrimet financiare derivative dhe jo-derivative, ndërkohë që maturimet kontraktuale të detyrimeve financiare derivative kërkojnë të paraqiten vetëm kur janë të rëndësishme për të kuptuar afatet e flukseve të parasë. Për kontrata garancie financiare të lëshuara, ndryshimet kërkojnë që shumën maksimale të garancisë të paraqitet në periudhën më të hershme në të cilën garancia mund të ushtrohet. Paraqitjet e lidhura me rrezikun e likuiditetit janë në shënimin 5 (c).

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Drejtimi i Grupit diskuton me Komitetin e Kontrollit zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të Grupit, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shënimi 5).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

Provizjione për humbje nga kreditë

Aktivët e regjistruara me kosto të amortizuara vlerësohen për të identifikuar rënie në vlerë të aktivit, në bazë të politikave të përshkruara në 3(i)(vi).

Përbërësi specifik në totalin e fondit të zhvlerësimit të aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë të flukseve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto flukse të parave drejtimi gjykon mbi situatën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të ndonjë garancie. Çdo aktiv i zhvlerësuar, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e flukseve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavaruar nga Risku i Kredisë.

Fondi i zhvlerësimit të portofolit mbulon humbje nga kreditë dhënë klientëve me karakteristika ekonomike të ngjashme, kur nuk ka ndonjë evidencë të dukshme për humbje, por humbja mund të ketë ndodhur dhe pse e paidentifikueshme në datën e pasqyrave financiare. Një element i fondit kolektiv për zhvlerësimin e kredive është rreziku i vendit ku është dhënë kredia. Në vlerësimin e nevojës për fond kolektiv, drejtimi konsideron faktor si cilësia e kreditimit, madhësia e portofolit, përqëndrimi si dhe faktorë ekonomik. Në mënyrë që të vlerësohet fondi i kërkuar, janë bërë supozime për të përcaktuar se si janë modeluar humbjet dhe për të përcaktuar parametrat e kërkuar, bazuar në të kaluarën ose nga kushtet aktuale ekonomike. Saktësia e vlerësimit të fondit kolektiv të zhvlerësimit varet nga sa të matshme janë flukset e ardhshme të projektuara nga aktivi dhe supozimet dhe parametrat e përdorura në modelin e vlerësimit.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë që paraqet rëndësinë e të dhënave të marra në përcaktimin e vlerësimit, të përshkruara si më poshtë:

•Niveli 2: Teknika vlerësimi të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme, qoftë në mënyrë direkte (si çmimet) ose në mënyrë indirekte (si për shembull të dhëna që rrjedhin prej çmimeve). Kjo kategori përfshin investime të vlerësuara duke përdorur: çmime të kuotuar të tregut në tregje aktive për instrumenta të ngjashëm; çmime të kuotuar për instrumenta identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë në mënyrë direkte ose indirekte të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohet në çmimet e kuotuar të tregut apo në kuotimet e tregtuesve. Për të gjithë instrumentët e tjerë financiarë, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi siç përshkruhen në politikën kontabël 3(i)(iv). Për instrumentët financiarë që kanë treg financiar, por jo aktiv dhe çmimi i tregut nuk është transparent mjaftueshëm, vlera është më pak objektive dhe kërkon shkallë variabël gjykimi në varësi të likuiditetit, përqëndrimit, pasigurisë e faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe risqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik.

5. Administrimi i rrezikut financiar

(a) Të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë Grupin ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Grupit ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Grupit.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

Struktura e administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për themelimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Bordi ka themeluar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Kredisë së Grupit, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të riskut. Të gjitha komitetet përbëhen nga anëtarë ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi Drejtues.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Grupi, për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontrolleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Grupi, nëpërmjet trainimeve, standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i kontrollit është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Grupi. Komiteti i kontrollit mbështetet nga kontrolli i brendshëm i Grupit për të kryer funksionet e veta. Kontrolli i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut, dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Kontrollit.

Zhvillimet aktuale

Grupi operon në kushtet e një zhvillimi dinamik të një krize financiare dhe ekonomike. Zgjerimi i saj mund të rezultojë në implikime negative të pozicionit financiar të Grupit. Drejtimi i Grupit performon çdo ditë monitorimin e pozicioneve të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve ndërkombëtare financiare, duke vënë në zbatim praktikat më të mira bankare. Drejtimi është i bazuar në analizat e fitimit, likuiditetit dhe kostos së fondeve dhe merr masa të përshtatshme në lidhje me kreditimin, tregun (kryesisht normën e interesit) dhe rrezikun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative të krizës globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Grupi i përgjigjet ndryshimeve të tregut, duke mbajtur një kapital dhe një pozicion likuiditeti të qëndrueshëm.

(b) Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare nëse klienti, apo pala e instrumentit financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet e klientëve, bankave dhe investimi në letra me vlerë. Për qëllime raportimi të administrimit të kredisë, Grupi konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si rreziku që rrjedh nga vetë klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori).

Për qëllime të administrimit të rrezikut, rreziku i kredisë nga letrat me vlerë të tregtueshme trajtohet në mënyrë të pavarur, por raportohet si një komponent i ekspozimit të riskut të tregut.

Administrimi i rrezikut të kreditimit

Bordi i drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Kreditimit të Bankës. Një divizion i veçantë i administrimit të rrezikut të kreditimit, i cili raporton te Komiteti i Kreditimit, është përgjegjës për mbikqyrjen e rrezikut të kredisë duke përfshirë:

- Formulimin e politikave të kreditimit duke u konsultuar me njësitë e biznesit, rreth kërkesave për kolateral, vlerësimin e kredive, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut, dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.
- Themelimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e faciliteteve të kreditimit. Komiteti i Kreditimit ose Bordi Drejtues i Grupit ka në dorë kufizimet për sa i përket autorizimeve të ndryshme.
- Mbikqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Grupi vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të kreditimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, përpara se facilitetet të jenë të angazhuara ndaj klientëve nga njësitë përkatëse të biznesit. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces rishikimi.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

•Të kufizojë ekspozimin ndaj palëve, zonave gjeografike dhe industrive (për huatë dhe parapagimet), bandën e klasifikimit të kredive dhe nivelin e kreditimit të institucionit financiar, likuiditetin e tregut dhe ndaj shteteve të ndryshme (për investimet në letra me vlerë).

•Zhvillimin dhe përdorimin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të Grupit në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë Drejtimin në rreziqet aktuale të Grupit. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të kreditimit. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut konsiston në dhjetë kategori të cilat reflektojnë shkallën e rrezikut të mospagimit dhe disponibilitetin e kolateraleve, ose lehtësime të tjera të rrezikut të kreditimit. Përgjegjësia për të caktuar nivelet e rrezikut është e niveleve që aprovojnë kredinë. Kategoritë e rrezikut janë subjekt i vëzhgimeve nga Divizioni i Administrimit të Rrezikut të Kreditimit të Grupit.

•Monitorimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit nga njësitë e biznesit, duke përfshirë dhe ato për industrinë e zgjedhura, rrezikut të vendit dhe llojeve të produkteve. Divizioni i Administrimit të Rrezikut të Kredisë merr dhe shqyrton rregullisht raporte mbi cilësinë e kreditimit dhe ndërmerr veprime përkatëse korrigjuese.

•Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe aftësi të specializuara njësite të biznesit për të zhvilluar praktikatat më të mira për administrimin e rrezikut të kreditimit në të gjithë Grupin.

Çdo njësi biznesi duhet të zbatojë politikatat dhe procedurat e Grupit për administrimin e rrezikut të kreditimit. Kontrolli i brendshëm kryen në mënyrë të rregullt kontrole ndaj njësite të biznesit dhe divizionit të administrimit të rrezikut.

(i) Investime në letra me vlerë

Pa vonesa dhe të pazhvierësuar (klasifikimi për qëllime të brendshme)	Investime të mbajtura për tregëtim		Investime të mbajtura deri në maturim	
	2009	2008	2009	2008
Klasifikimi i vendit: B2	-	8,661,705	-	-
Klasifikimi i vendit: B4	36,524,191	13,215,584	93,189,711	115,992,749
Vlera kontabël	36,524,191	21,877,289	93,189,711	115,992,749

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

(ii) Hua dhe paradhënie klientëve

	2009	2008
Të zhvlerësuar individualisht		
Shkalla 5: Të zhvlerësuar	8,432,858	2,153,907
Vlera Bruto	8,432,858	2,153,907
Provigjon për zhvlerësim	(4,649,622)	(1,406,318)
Vlera kontabël (A)	3,783,236	747,589
Provigjone për humbjet bazuar në portofol		
Shoqëritë		
Shkalla 1	8,422,480	8,892,841
Shkalla 1.5	3,850,042	7,153,586
Shkalla 2	6,872,231	6,292,073
Shkalla 2.5	4,479,439	6,956,334
Shkalla 3	8,617,462	7,965,754
Shkalla 3.5	18,579,786	16,336,120
Shkalla 4	10,057,152	4,249,189
Shkalla 4.5	6,193,412	2,260,391
Shkalla 5 (pa klasifikuar)	2,587,918	48,835
	65,459,922	60,155,123
Individë	20,384,531	23,337,150
Vlera bruto	85,844,453	83,492,273
Provigjon për zhvlerësim	(1,299,049)	(864,935)
Vlera kontabël (B)	84,545,404	82,627,338
Me vonesë por jo të zhvlerësuar përfshin:		
30-60 ditë:	1,445,842	3,966,064
60-180 ditë:	1,469,885	825,978
Vlera kontabël	2,915,727	4,792,042
Vlera kontabël Totale (A+B)	88,328,640	83,374,927

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar janë ato hua dhe letra me vlerë për të cilat Grupi ka përcaktuar se është e mundur që mos të arkëtojnë të gjithë shumën e interesit dhe të huasë në bazë të kushteve të kontratës. Këto hua vlerësohen me shkallën 0.5 deri në 5 në sistemin e brendshëm të kategorizimit të rrezikut.

Hua me vonesë por jo të zhvlerësuar

Hua dhe letra me vlerë ku pagesat e interesit janë me vonesë por që Grupi beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të sigurisë / kolateralit të vlefshëm dhe /ose shkallës së arkëtimit të shumës së huasë.

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

Hua me kushte të rinegociueshme.

Hua me kushte të rinegociueshme janë hua të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe kur Grupi ka bërë lëshime të cilat nuk do ti bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar, qëndron në të njëjtën kategori, edhe pse performanca pas ristrukturimit mund të përmirësohet.

Fondi për zhvlerësim

Grupi vendos një provigjon për humbjet nga zhvlerësimet që përfaqëson vlerësimin e Grupit për humbjet e ndodhura të portofolit. Përbërësit kryesorë të këtij provigjoni janë, një komponent për humbjet specifike që lidhet me ekspozimet e konsiderueshme individuale, dhe një provigjon i përgjithshëm për grupet e aktiveve të ngjashme në lidhje me humbjet e realizuara por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësime.

Politikat e nxjerrjes jashtë përdorimit

Grupi nxjerr jashtë përdorimi një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjon për humbjet nga zhvlerësimi) kur Komiteti i Kredive me probleme të Grupit vendos që huatë/ letrat me vlerë janë të pa-arkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhia e ngjarjeve të konsiderueshme të cilat kanë ndikuar në gjendjen financiare të huamarrësit në mënyrë të tillë që ai nuk është në gjendje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total.

Më poshtë është paraqitur analiza e shumave neto dhe bruto (e provigjoneve për zhvlerësim) të aktiveve individualisht të zhvlerësuar, sipas shkallës së riskut

Hua dhe paradhënie klientëve

	Bruto	Neto
31 Dhjetor 2009		
Individualisht të zhvlerësuar		
Shkalla 5: Të zhvlerësuar	8,432,858	3,783,236
Totali	8,432,858	3,783,236
31 Dhjetor 2008		
Individualisht të zhvlerësuar		
Shkalla 5: Të zhvlerësuar	2,153,907	747,589
Totali	2,153,907	747,589

Grupi mban kolaterale për huatë dhe paradhëniet klientëve në formën e hipotekave për pasuritë, letra të tjera me vlerë të bllokuara dhe garanci. Vlerësimet e vlerave të drejta bazohen në vlerën e kolateralit në kohën kur merret huaja, dhe në përgjithësi nuk ndryshohen përveç rasteve kur huaja zhvlerësohet individualisht. Për huatë që u jepen bankave të tjera nuk mbahet kolateral, përveç rasteve kur letra me vlerë mbahen si pjesë e riblerjeve të anasjellta dhe aktivitetit huamarrës të letrave me vlerë. Në përgjithësi nuk mbahet kolateral për investimet në letrat me vlerë, dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009 dhe 31 dhjetor 2008 nuk është mbajtur një kolateral i tillë.

	2009			2008
	Kundrejt zhvlerësimeve individuale	Kundrejt zhvlerësimeve kolektive	Totali	Totali
Prona	2,012,033	25,706,276	27,718,309	150,679,386
Peng	783,326	11,995,421	12,778,747	111,215,797
Para	157,249	2,009,056	2,166,305	7,645,169
Garanci	382,350	4,885,015	5,267,365	3,935,567
Totali	3,334,958	44,595,768	47,930,726	273,475,919

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009
(të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

Grupi vëzhgon përqëndrimin e rrezikut të kreditimit në bazë të sektorëve dhe zonave gjeografike. Analiza e përqëndrimit të rrezikut të kreditimit më 31 Dhjetor 2009 dhe 31 Dhjetor 2008 paraqitet më poshtë:

	31 Dhjetor 2009				31 Dhjetor 2008							
	Individë	Korporata	SME Biznese të vogla	Punonjës Totali	Individë	Korporata	SME Biznese të vogla	Punonjës Totali				
Overdraft	2,366,729	35,364,282	6,248,486	1,082,969	34,274	45,096,740	4,178,253	28,594,080	8,042,854	191,465	30,147	41,036,799
Karta krediti	99,092	-	-	3,436	102,528	-	-	-	-	-	-	-
Huatë				1,709,408								
Afat-shkurtër	130,112	1,573,467	-	4,888	941	18,084,193	291,155	1,900,072	422,258	-	636	2,614,121
Afat-mesëm	3,641,415	9,324,112	4,321,666	619,857	177,143	19,128,837	4,441,122	8,293,487	6,203,375	98,626	203,349	19,239,959
Afat-gjatë	8,717,145	7,045,419	3,112,167	44,605	209,501	(410,918)	8,591,693	4,893,493	2,983,715	2,496	177,517	16,648,914
Minus tarifa administrative	(162,805)	(138,879)	(87,549)	(21,685)	-	38,511,520	-	-	-	-	-	-
	12,325,867	17,804,119	7,346,284	647,665	387,585	38,511,520	13,323,970	15,087,052	9,609,348	101,122	381,502	38,502,994
Hipotekë	5,880,734	-	-	218,034	928,489	7,027,257	5,232,522	-	-	9,054	714,563	5,956,139
Të tjera	310,415	2,002,891	1,221,957	2,953	1,051	3,539,267	100,516	37,534	10,980	61	1,157	150,248
Totali	20,982,837	55,171,292	14,816,727	1,951,621	1,354,835	94,277,312	22,835,261	43,718,666	17,663,182	301,702	1,127,369	85,646,180

Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009 (të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

Vlera kontabël më 31 Dhjetor 2009	Hua dhe paradhënie klientëve	Balanca të kushtëzuara	Investime të mbajtura për tregtim	Investime të mbajtura deri në maturim
Shqipëria	92,783,414	19,671,528	36,524,191	93,189,711
Amerika e Veriut	-	-	-	-
Europa	1,493,898	673,779	-	-
Totali	94,277,312	20,345,307	36,524,191	93,189,711
Vlera kontabël më 31 Dhjetor 2008				
Shqipëria	83,933,144	21,170,205	13,215,584	115,992,749
Amerika e Veriut	-	16,000	-	-
Europa	1,713,036	1,093,547	8,661,705	-
Totali	85,646,180	22,279,752	21,877,289	115,992,749

Minimumi i pagesave të qerasë

Qiraja financiare paraqitet sëbashku me hua dhe paradhënie klientëve. Më poshtë paraqitet një rakordim i investimit bruto me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qirasë:

	2009	2008
Investimi bruto	3,958,921	3,003,159
Të ardhura financiare të parealizuar	(524,793)	(519,218)
	3,434,128	2,483,941

Rreziku i vendosjes

